Xhafer Durmishi

SKENDER

VEPRA
7

NË RRETHIN E SHTUTGARTIT

Kujtime për Jusuf e Bardhosh Gërvallën dhe rrethin e tyre në Shtutgart

1. Mos më harro?
2. Studentë që në pushimet verore punonin në Zvicër
3. UNË E KAM FAJIN
-1. Lëvizja më ka gjetur mua
-2. Lajmëtari i lirisë
-3. Nga Zurichu në Stuttgart
-4. Shtëpia e vëllezërve Gërvalla
-5. Unë e kam fajin
-6. Gazeta Bashkimi nuk del më!
4. TRUPROJË APO TURPROJË
5. TEORIA DHE PRAKTIKA
6. Punëtorët dhe të papunëtorët
7. KOMUNIKATA E LËVIZJES SË JUSUF GËRVALLËS PËR DEMONSTRATAT E VITIT 1981
8. PËRGATITJET PËR BOTIMIN E ZËRIT TË KOSOVËS

9. FORMIMI I KOMITETIT TË DEGËS
10. Na nevojitet mendimi juaj i prerë
11. ASPEKTE EKONOMIKE RRETH LUFTËS DHE LËVIZJES SË JUSUF GËRVALLËS
-1. Unë isha pa pasaportë me pak të holla të xhep
-2. Se ke për gjë të kërkosh të holla te emigracioni
-3. Unë i jam përmbajtur marrëveshjes, ata jo
-4. Shabani është një milioner
-5. Arriti shuma e të hollave që kërkoheshin prej tij
-6. Kërkonte një njeri "të ndershëm e trim"
-7. Mendime të urta dhe të njerëzishme
-8. Ai personi që na i patë dhënë 3 mijë markat
-9. Jusufit i vijnë 10 mijë dollarë amerikan nga Turqia
-10.E BIJA E JUSUF GËRVALLËS, DONIKA DEMANTON
-11. NË RRUGËN NËPËR TË CILËN MË KANË ARRITUR KËTU PARATË E MBLEDHURA PËR MAKINË
-12. Korrektësia e tij shfaqej në çdo gjë
12. TEZAT RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS TË OMLK-së
13. Pse ke ardhur?
14. A vlejnë këto fjalë edhe për mua?
15. Festa e 28 Nëntorit 1981 në Shtutgart
16. Kërkesa e Jusufit rreth Kongresit VIII të PPSH
17. THEMELI ËSHTË VËNË ME TË PAVËRTETA
18. NE DO TË DALIM PUBLIKISHT ME SHESHIMIN E TË PAVËRTETAVE
19. Tik-taket e orës në Untergruppenbach
20. DIGA E DRINIT

1. Mos më harro!

Sipas mendimit tim, rrethanat e jetës dhe rasti ka ndikuar që të takohem me Jusufin e Bardhin. Përkundër faktit se unë takimin me Jusufin e Bardhin ia lë rastit, ka disa njerëz kokëfortë e me mendime të pandreqshme që thonë se kjo punë nuk ka qenë e rastit, se asgjë e rëndësishme nuk është e rastit por rezultat i një pune të gjatë sistematike, se rasti nuk është asgjë tjetër pos pseudonimi i zotit, kur ai nuk do të nënshkruhet me emër. Për t'ua dhënë këtyre një përgjigje, e për t'i hequr qafesh njëherë e përgjithmonë dua t'i them në mënyrën më të shkurtë disa ngjarje në jetë që i kanë parapri njohjes time me Jusufin.

Nëna ime më ka tregua se kam lindur natën e Shën Gjergjit (megjithëse në librin e amzës jam regjistruar në një datë tjetër). Ajo nuk ka ditë shkrim e lexim dhe nuk ka përdorë kalendar. Këtu lindin disa paqartësi të cilat unë nuk mundem dhe nuk kam për qëllim me i ndreq. Në disa shtete nata e Shën Gjergjit është 5 maji e në disa të tjera 22 prilli. Edhe sikur të më ishte dhënë mundësia me zgjedhë unë nuk kisha mund me thënë se cila datë është më e rëndësishme për ditëlindje. Për mua si 5 maji ashtu edhe 22 prilli e kanë të njejtën peshë.

Përndryshe urtësia ime në vitet e para të fëmijërisë ka qenë shembullore sa të gjithë më kanë quajtur bogolinë. Shkollën fillore e kam kryer në fshatin fqinjë të banuar me serb, në Prilluzhë. Në oborrin e kësaj shkolle, pas klasës së pestë jam takuar me Asllan dhe Shaban Muharremin nga Mihaliqi. Duke i parë aftësitë e mia asimiluese të mësimit dhe urtësinë time premtuese, arsimtarët shqiptarë me pajtimin dhe nënshkrimin e drejtorit

serb, në ditën e mbarimit të shkollës fillore ma kanë dhënë Diplomën e Vukut. Me sa di unë, me aq sa kam mund të bëjë hulumtime nëpër biblioteka e arkiva të ndryshëm, unë jam i vetmi nga Stan**ovce** që jam quajtur **bogolinë** dhe për këtë kam marrë si shpërblim Diplomën e **Vukut.** Nga kjo rrjedh se jam i vetmi që shkollës fillore ia kam filluar me xhemperin e leshit të qingjit dhe e kam mbaruar me qimen e ujkut.

Përkundër këtij fakti, unë kam treguar afinitet për t'u ndikuar nga propaganda patriotike. Edhe pse kam qenë nxënës i mirë, kjo sa i ka gëzua prindërit ndoshta aq edhe i ka shqetësua. Gëzimi i tyre ka qenë se duke u shkolluar mund të më pret një jetë më e lehtë se sa e atyre dhe një kualifikim shkollor do të më jep mundësi ta takoj ndonjë rob të mirë, ndërsa frika ka qenë se mos shkollimi nuk do të më afroj me robët, por do të ndodhë pikërisht e kundërta, do të më vej në kontakt me robijasha.

Pas shkollës fillore jam regjistruar pa provim pranues në Shkollën e Mesme Teknike "Nikolla Teslla" në Obiliq. Regjistrimi pa provim pranues ka qenë i mundur pasi ata që e kanë pasur Diplomën e Vukut i kanë gjetur tarabat çelë dhe kanë qenë të mirëpritur kudo. Në ditën e regjistrimit në shkollën e mesme, pasi jam regjistruar, pas një qëndrimi të gjatë në rend, kemi dalë për shetitje nëpër Obiliq me një shok nga fshati. Nga dera e një restoranti më ka thirrë një burrë i moshës së mesme. Unë nuk e njihja dhe mendova se më ka përzier me tjetër kend, por ai më thirri prapë duke më thënë se më kërkonte pikërisht mua. Shkova tek ai, më ftoi në tavolinën e tij ku u ula, pak i ndruajtur pasi nuk e dija shkakun e thirrjes së tij. Ai porositi një pije freskuese për mua. Në mes nesh u zhvillua kjo bisedë:

Prindi NN: A u regjistrove në shkollë?
Xh. D. Po.
Prindi NN: E kam ditur. Kam qëndrua afër teje në rend, me djalin tim dhe e pash se ke qenë nxënës i mirë. E mora vesh nga një bisedë në rresht se e kishe Diplomën e Vukut. Djali im nuk u pranua sepse nuk ka mësua sa duhet edhe pse i ka pasur kushtet. Për këtë jam i mërzitur.
Xh. D: Më vjen shumë keq.
Prindi NN: Megjithatë mua më vjen mirë që ti je pranua. Prandaj edhe të thirra me e heq mërzinë e kësaj dite. Djali im më ka idhnua sot, por ti më ke gëzua. Unë do të isha shumë i kënaqur po ta kisha pasur një djalë si ti.

Xh. D: Në atë rast edhe unë do të kisha pasur dëshirë që të bëja çdo gjë që është e mundur që të krenohesh me mua.

Prindi NN: Mos e harro mërzinë time sot, por edhe këtë çast gëzimi. Ngado që të jesh, mbaje mend se dikush mund të gjendet afër teje dhe mund ta sheh punën tënde. Të thirra që ta kujtosh këtë bisedë si një lloj përgjegjësie që e ke ndaj një prindi në një ditë të mërzitshme. Mos më harro!
Xh. D. Nuk do të harroj kurrë!

Kjo është përmbajtje e bisedës me prindin NN të cilën nuk e kam harruar kurrë. Por jo të gjitha ngjarjet fiksohen në memorie.

Shkollën e mesme e kam filluar në vjeshtën e vitit 1973. Në këtë shkollë në mënyrë indirekte kam dëgjuar pak, për herë të parë për Goli Otokun dhe Lepogllavën por jo më shumë. Pas mbarimit të vitit të parë me sukses të shkëlqyeshëm, Kombinati i Obiliqit, i cili ka qenë pronar i Shkollës së mesme, më ka dërguar dy javë ditë për pushime

verore në Ulqin, në kampshtëpizat e veta. Këto dy javë, në shenjë solidariteti, me ata që kanë qenë në Lepogllavë dhe Goli Otok, më shumti i kam kaluar në Najllon Pllazhë. Unë jam shumë i vetëdijshëm se Najllon Pllazha nuk mund të krahasohet me Goli Otokun e Lepogllavën, por siç thonë njeriu lufton me atë çka e ka, prandaj kisha dashtë që ky fakt të merret parasysh.

Pas mbarimit të shkollës së mesme jam regjistrua në Fakultetin Xehtaro Metalurgjik në Mitrovicë, dega e teknologjisë.

2. Studentë që në pushimet verore punonin në Zvicër

Gjatë studimeve në Mitrovicë mund të them se në dy vite kam banuar në Mitrovicë e në dy tjera kam udhëtuar me tren. Në Mitrovicë kemi vazhduar studimet pothuajse të gjithë ne nxënësit më të mirë të klasës në Obiliq, si Mehmetali Cej, I. Thaçi, Q. Thaçi, Tahir Konjuhi dhe unë. I. Thaçi e Q. Thaçi nga S., në vjeshtën e vitit 1979 kanë banuar në konviktin e shkollës së mesme 'Silvira Tomasini' në Mitrovicë. Në këtë konvikt ka qenë vështirë me u vendosë, por ata e kanë pasë referentin e konviktit farefis, megjithëse jo krejt të afërm. Unë kam bujtur shpesh në këtë konvikt në dhomën e I. e Q. Në këtë konvikt jam njohur me Zymer Shoshin nga Skivjani i komunës së Gjakovës. Me Zymerin, I., Q. e B. H., jemi shoqëruar shumë në kohën e lirë. Zymeri na tregon se gjatë verës së vitit 1979 gjatë pushimeve verore ka qenë në Zvicër, dhe duke iu falenderua lidhjeve familjare ka punuar tërë verën atje. Duke iu falenderua këtij fakti, Zymeri e ka pasur në atë vit standardin më të mirë prej të gjithë ne studentëve. Se studentë të ndryshëm shkonin jashtë për të punuar, përmes lidhjeve familjare kisha dëgjuar edhe prej të tjerëve. Por përshkrim e rast më të afërt e më konkret nuk kisha pasur se ai i Zymer Shoshit.

Pas regjistrimit të studimeve kisha marrë pasaportën në Mitrovicë. I ndikuar nga përshkrimi me mjaft ngjyra i Zymer Shoshit, gjatë pushimeve verore të vitit 1980, kam shkuar në Zvicër edhe unë, pasi kisha disa të afërm.

3. UNË E KAM FAJIN

-1. Lëvizja më ka gjetur mua
-2. Lajmëtari i lirisë
-3. Nga Zurichu në Stuttgart
-4. Shtëpia e vëllezërve Gërvalla
-5. Unë e kam fajin
-6. Gazeta Bashkimi nuk del më!

-1. Lëvizja më ka gjetur mua

Në fillim të vitit 1978, shokët e Organizatës, Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, e cila ka vepruar në fshehtësi, në komunën e Vushtrrisë, më kanë propozuar që të anëtarësohem në Lëvizjen konkrete, me emrin konkret 'Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Këta shokë të Jusufit (edhe pse nuk e kanë ditur në atë kohë se janë në të njëjtën organizatë me Jusufin, edhe pse nuk e kanë ditur se kanë fatin të jenë në një Organizatë me Jusufin) kanë menduar se unë mund të kontribuoj për të mirë në këtë Lëvizje konkrete. Edhe unë kam besuar sikur ata dhe e kam pranuar propozimin e tyre. Duke pasur parasysh kushtet e veprimtarisë në ilegalitet të thellë mund

të thuhet se nuk ka ekzistuar mundësia që unë ta kërkoj rrugën deri tek Organizata e Jusufit, por ka ndodhë e kundërta, ajo më ka gjetur mua.

* * *

Ka qenë dëshira ime ta studioj gjuhën dhe letërsinë, por ndikimi i rrethit, dhe mësimdhënësve të shkollës Nikolla Teslla, të cilën në të njejtën kohën ishin edhe ligjërues në Fakultetin e Teknologjisë ndikuan që të regjistrohem në Mitrovicë.
Krahas studimeve, jam munduar qoftë edhe krejt sipërfaqësisht ta përcjellë jetën kulturore në Kosovë.

Për herë të parë Zërin e Jusuf Gërvallës e kam dëgjuar përmes valëve të radios. Nuk më kujtohet në cilin vit, por e mbaj mend shumë mirë si kuriozitet kur në Zërin e rinisë e kam lexuar një poezi të cilës nuk ia mbaj mend emrin por ajo që më bëri përshtypje ishte se i tregova menjëherë një shoku duke i thënë: shihe, këngëtari Jusuf Gërvalla po shkruaka edhe poezi. Në vitin e 100 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit Jusufi ishte i dalluar, ndërsa përcjellja e Trupës së Radiotelevizionit Shqiptarë nëpër Kosovë ishte kulmi i disponimit dashamirës dhe admirues për Jusuf Gërvallën.

Për arratisjen e tij jashtë atdheut pata mësuar nga Abdullah Hashani, shokë i studimeve.

Pas regjistrimit të studimeve, kam marrë pasaportën në Mitrovicë. Kah fundi i vitit 1979 në Kosovë bëhen arrestime të disa anëtarëve të Lëvizjes së Jusufit, por jo edhe të atyre me të cilët unë kam pas lidhje direkte, andaj nuk kam pas nevojë për ndonjë shqetësim direkt për personin tim. Jusufi arratiset nga Kosova dhe më 21 dhjetor 1979 mbërrin në Shtutgart.

Me sa më kujtohet, përafërsisht në të njëjtën kohë, në të njëjtën javë, për arsye krejtësisht private, në bazë të lidhjeve familjare, e me iniciativën e kësaj lidhjeje, kam bërë udhëtimin e parë jashtë shtetit, dhe kam qëndruar pjesën kryesore të pushimit shkollor-dimëror 1979-1980 në Berlinin Perëndimor, pa përjashtuar as shëtitjet në Berlinin Lindor. Për këtë rrugë të gjitha shpenzimet i ka paguar personi i farefisit tim i cili ka punuar në Berlin. Poashtu në bazë të lidhjeve familjare, në pushimet verore të vitit 1980 kam punuar në Zvicër.

Gjenerata jonë në sistemin e Jugosllavisë vetëqeverisëse e kishte një hapësirë të vogël për të luftuar që ta përmirësoj gjendjen e vet. Ndërsa shteti, po ta shohim çështjen edhe vetëm e vetëm nga aspekti social, pa e llogaritur komponentën e fuqishme që kishte historia kombëtare, nuk kishte aftësi ta absorboj në sistemin e vetë numrin e madh që merrnin arsim të lartë. Ushqimi ynë kryesor shpirtëror na vinte përmes valëve të Radio Tiranës. Por në verën e vjeshtën e vitit 1980, në Kosovë ndodhë diçka e jashtëzakonshme, që nuk kishte ndodhur më parë në atë masë, a jo ishte shpërndarja e gazetave Bashkimi dhe Lajmëtari i lirisë.

-2. Lajmëtari i lirisë

Një pasdite në vjeshtën e vitit 1980, Ismet Megjuani ma dha numrin e parë të *Lajmëtarit të lirisë*, dhe kërkoi që t'ia kthej brenda një jave. Leximi i *Lajmëtarit* ishte një përjetim e një ngritje për mua që kurrë nuk më kishte ndodhur me ndonjë tekst më parë. Këtë revistë ditën e mbaja në shtëpi, ndërsa natën e paloja të mbështjellur në një duek të tallës së misrit që priste për të xhvoshur. Këtë e bëja si masë sigurie që në rast të ndonjë bastisje të mos gjendet revista në shtëpi. Në natën e fundit përkundër mbështjelljes, një mi kishte arritur me e grimcua një qoshe të mbështjellëses por fletët e revistës kishin mbetur të padëmtuara.

Diskutimi me disa shokë ishte se ku mund të botohet *Lajmëtari i lirisë* dhe kush mund të qëndroj pas tij?

Nga përgatitja teknike dhe cilësia e letrës mendja na shkonte se *Lajmëtari i lirisë* është bërë jashtë, në Perëndim. Në pyetjen se kush mund të qëndroj pas artikujve të Lajmëtarit, në rrethin tim diskutimet silleshin rreth tre personave: Shukri Rahimit, autorit të Vilajetit të Kosovës, Rexhep Qosjes dhe Jusuf Gërvallës.

Lajmëtari i lirisë nuk kishte dalë në emër të ndonjë organizate. Mund të thuhet se ai në radhë të parë kishte dalë në emër të një motoje, e shprehur përmes një fjalie programatike që ishte vendosur pjesërisht mbi dhe pjesërisht nën titullin e revistës:

Me pushkë dhe penë...

lajmëtari i lirisë

...për liri dhe bashkim me vendin amë, Shqipërinë socialiste!

Në janar të vitit 1981, me kërkesën e dy shokëve të Lëvizjes së Jusufit, me të cilët kam pas kontakt, (Sheremet dhe Ismet Saraçi) kam udhëtuar për në Stamboll për ta takuar Sabri Novosellën. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi m'i kanë paguar dy shokët që më kanë dërguar, të cilët kanë punuar si arsimtarë në një shkollë fillore. Sabri Novosellën e kam takuar në banesën e Tefik Strajës, në Cigdem sok. Nr. 24/6, Pendik, Istanbul. Pa u zgjeruar shumë me këtë rast, dua të them se Sabriu e ka marrë vesh nga unë ekzistencën dhe botimin e revistave „*Lajmëtari i lirisë*“ dhe „*Liria*“. Edhe pse ia kam përmend se në Kosovë flitet shumë për Jusuf Gërvallën, Sabriu nuk më ka thënë se Jusufi është i organizatës tonë, apo se fare e njeh. Pas qëndrimit disa ditësh në Stamboll, para se me u nda, Sabriu ma ka dhënë numrin e telefonit të banesës së vetë në Adapazar.

Pas kthimit tim nga Stambolli, pas rreth dy muajve filluan ngjarjet historike të Pranverës 1981.

Për faktin se Jusufi gjendet dhe vepron në rrethin e Shtutgartit ka pas shkruajtur shtypi i Beogradit, në javët pas demonstratave të Pranverës 1981.

Dhuna policore, ndjekja e aktivistëve të organizatave politike dhe ngjarjet që u zhvilluan lanë gjurmë të ashpra tek unë. Duke pasur parasysh veprimtarinë time modeste në Kosovë dhe shqetësimin e madh psikik, i cili nuk ishte në proporcion me punën time, në marrëveshje edhe me shokët që kisha kontakt, në qershor 1981 shkova tek të afërmit e mi në Zvicër, për të punuar, ashtu siç kisha bërë një vit më parë. Me vete e kisha numrin e telefonit të Sabriut. Pas disa ditësh e kam thirrur në telefon dhe i kam treguar se jam në Zvicër. Në bisedën e parë, Sabriu ma ka dhënë numrin 0049714126091, i cili ka qenë numri i telefonit të zyrës së Bardhosh Gërvallës në Ludwigsburg, në Solitudestrasse 44, dhe më ka thënë që të merrem vesh me Bardhin dhe të shkoj në Shtutgart.

-3. Nga Zurichu në Stuttgart

Rreth, apo pikërisht më 17 korrik 1981, rreth orës 8 të mëngjesit, kam marrë trenin nga Zurichu për në Shtutgart. Ditën e nisjes, një ditë të premte, ma caktoi Bardhoshi. Në kufirin gjerman në Singen, policia më zbriti nga treni, më mbajtën pak kohë në stacion. Më pyetën se ku shkoja, e unë ua dhashë emrin dhe numrin e telefonit të Bardhoshit. Ata e kishin pas thirrur Bardhoshin dhe pasi fjalët e mia ishin përputhur me të Bardhit, më lejuan të vazhdoj rrugën, por ai treni të cilin e kisha marrë në Zurichu më iku, gjatë kohës kur unë isha në stacion të policisë, dhe me trenin tjetër të radhës arrita në Shtutgart. Nga Shtutgarti e thirra prapë Bardhoshin në telefonin e tij të zyrës që t'i tregoj se kam mbërri, ndërsa ai më dha udhëzime se në çfarë mënyre ta marrë trenin lokal për Ludvigsburg dhe unë ashtu veprova. Edhe kur mbërrina në Ludvigsburg prapë e thirra dhe nuk vonoi e

erdhi. Në zyrën e Bardhoshit e takova Naim Haradinajn. Me Bardhin nuk më ra të bisedoj aq shumë. Me fjalë të shkurta ma dha një shpjegim për punëdhënësin e tij Arbeiterwohlfart, dhe punën e tij si punëtor social i shtetit gjerman, për punëtor të viseve të ndryshme të ish-Jugosllavisë, pasi ai e pa se mua më bëri përshtypje harta e Jugosllavisë në muret e zyrës, ashtu siç ishte harta e Turqisë në një zyrën bashkangjitëse, e punëtorit social nga Turqia. Nuk më ra të bisedoj shumë sepse ai ishte marrë vesh me dikend për ta marrë një motor të një kerri, kështuqë mua më la me Naimin. Kur u kthye pas punës së kryer sa i përket motorit u nisëm unë Naimi e Bardhoshi për në Untergruppenbach. Rrugës Bardhoshi më tregoi se kemi me marrë një bashkatdhetar që poashtu do të ishte mysafir atë natë tek vëllezërit Gërvalla të cilin do ta prisnim në stacionin e trenave në Heilbron, me të cilën Jusufi e Bardhoshi ishin njohur gjatë organizimit të një prej demonstratave në Gjermani. Në orën e caktuar ai bashkatdhetari mbërrini. Në tren si duket kishte qenë duke e lexuar vëllimin e njëzet të veprave të Enver Hoxhës, dhe me libër në dorë, pa e futur në çantë erdhi me Bardhin në kerr ku ishim unë e Naimi. Ishte mendimi im, por edhe Bardhi më porositi që të mos e jap emrin tim të vërtetë para atij bashkatdhetari që po e prisnim. Kështu në mes orës 17.00-18.00 në mbrëmjen e nxehtë të mesit të korrikut 1981 mbërrina tek shtëpia e Vëllezërve Gërvalla në Untergruppenbach, në Habichthöche 40.

Mund të thuhet, se kjo ishte trokitja, ndodhja ime e parë para derës historike të historisë, por nuk është krejtësisht ashtu. Bardhoshi me ne që ndodheshim në veturën e tij, një citroen me ngjyrë të kuqe, muarëm atë rrugë që ai e merrte çdo herë kur voziste, atë të garazhës historike. Pra për në shtëpinë e vëllezërve Gërvalla kishte dy hymje. Ajo kryesorja, nga dera kryesore e shtëpisë, në rrugën Habichthöche 40, dhe tjetra përmes garazhës, kopshtit të gjelbëruar, derës së madhe prej qelqi e në dhomën e madhe të ditës, në katin e parë, apo në katin përdhes. Pjesa me e madhe (apo krejt) e katit të parë që ndodhej në anën e kopshtit ishte prej qelqi. Perdet e zgjedhura me kujdes, qëndronin anash, madhështore për t'i shërbyer skenës, në të cilën u zhvilluan shumë drama.

Jusufi na priti me gëzim e me të qeshura. Mua nganjëherë e tërë kjo ndodhi e i tërë ky udhëtim më dukej si ëndërr. E kisha paramenduar më trupgjatë dhe u befasova pak nga trupi i tij i vogël. Naimi më ndihmoi dhe së bashku shkuam në katin e dytë për ta lënë çantën time në dhomën e mysafirëve. Pas një përshëndetje të vogël me Jusufin, deri sa po përshëndeteshim me të gjithë, u morëm vesh që të prezantohesha para të gjithëve që do i takoja me emrin Skënder. Nuk vonoi dhe na u shtrua darka, por në ato momente, edhe pse dita më kishte kaluar në rrugë, nuk e ndieja veten aspak as të lodhur, as më shkonte mendja te buka. Përveç "zhgënjimit" nga shtati i shkurt, idealizimet që i kisha bërë me kohë në kokën time, në çastet e para nuk kisha asnjë nevojë t'i ndryshoj. Pikëpamja ime fillestare ishte se takimi ynë që prej çastit të parë ishte takim i karakterizuar nga pabarazia a asimetria. Unë kisha dëgjuar për te para shumë vitesh e ai për mua jo. Unë prisja që prej tij të marrë çdo gjë, pa pasur vetë asnjë mundësi t'i jap diçka.

Në atë mbrëmje ai mysafiri tjetër ishte më i moshuar se ne të gjithë. Me Jusufin ai ishte njohur në muajt e fundit. Ata folën më së shumti atë natë, ndërsa unë vetëm dëgjoja, kënaqesha duke dëgjuar dhe nuk kisha as nevojën më të vogël me ndërhy ndonjëherë. Kështu me bisedimet e asaj nate kaloi mbrëmja, e kaloi nata dhe na zuri agimi i ditës së nesërme, dhe ne shkuam për të fjetur tek rreth orës 6 të ditës vijuese.

Në raste të tilla, kur një njeri i panjohur e i "vogël" e takon një njeri të njohur e të "madh", ka shumë njerëz prej atyre "të mëdhenjve" që shqetësohen se po tkurren, ngushtohen gjatë takimit, stërpikjes dhe ndotjes së tyre gjatë ndeshjes e fërkimit me "vogëlsirat "apo "gjysmanalfabetët". Këtë frikë këta të "mëdhenj" e kanë kur t'i takosh në vende publike, sepse në ambientin e tyre familjar nuk ke mundësi që t'i takosh kurrë.

Jusufi nuk lodhej kurrë për këto çështje e për këto komplekse të "njerëzve të mëdhenj". Për te çdo njohje ishte një mundësi për një takim origjinal, dhe më duket sikur asgjë tek ai nuk transmetohej në reprizë. Duke dëgjuar bisedat që u bënë atë të premteje gjatë gjithë natës, pa pasur nevojë të bëjë asnjë pyetje pata rastin t'i mësoj disa gjëra që kishin ndodhur në vitin 1980 dhe për disa aspekte të zhvillimit të demonstratave në Evropën Perëndimore gjatë pranverës dhe verës 1981.

Me sa më kujtohet, të nesërmen në orët e pasditës, mysafiri që e mori Bardhi në stacionin hekurudhor të Heilbronit shkoi. Të shtunën tek Jusufi erdhi Haxhi Berisha, i cili punonte dhe banonte në rreth të Ludvigsburgut. Por Jusufi ishte mësuar me të shtunat e vikendet me Naimin, Haxhiun, etj. andaj kësaj të shtuneje patëm rastin të bisedojmë më shumë. I tregova në pika të shkurta për veten time dhe raportet e mia me LNÇKVSHJ, sidomos se si isha njohur me Sabri Novosellën, i cili më kishte drejtuar për tek Jusufi e Bardhoshi.

-4. Shtëpia e vëllezërve Gërvalla

Shtëpia e vëllezërve Gërvalla, në terminologjinë e arkitekturës më duket se i përshtatet ajo që në gjermanisht quhet **Stadthäuser**. Në katin e parë apo përdhes, ishte salloni - dhoma e madhe ditës, kuzhina, një korridor i vogël për varjen e teshave tek hyrja kryesore. Në katin e dytë ishin tri dhoma, një më e madhe e dy më të vogla. Në dhomën kryesore të këtij kati ishte dhoma e fjetjes së Jusufit e shoqes së tij, tjetra ishte për fëmijët, ndërsa një më e vogël, e cila kishte dritaren e madhe, kah kopshti ishte ndarë për mysafirët. Në katin e tretë kishte tri dhoma, një mjaft a madhe dhe dy më të vogla. Në këtë kat ishte dhoma e fjetjes së Bardhoshit dhe shoqes së tij, një tjetër për fëmijë, dhe ajo më e madhja ishte studioja, dhoma e punës së Jusufit, dhoma në të cilën ai shkruante. Në njërën anë të kësaj studioje të madhe ishte një kauç dhe një tavolinë, në murin në të cilin ishte edhe dera e hymjes ishte biblioteka, ndërsa përgjatë krejt murit tjetër, paralel me kauçin dhe ulëset ishte një tavolinë e gjatë prej qoshit në qosh, e cila shërbente për punë dhe dy karrika zyrash me rrota në këmbë. Një pjesë e kësaj tavoline të gjatë prej ishte prej qelqi, pjesë në të cilën bëhej përgatitja grafike e revistave. Në të ndodheshin dy makina shkrimi, njëra më e shtrenjtë dhe më e avancuar ishte e markës Oliveti, ndërsa një tjetër të cilën Jusufi e përdorte vetëm për shkrimin e artikujve ishte e markës, me sa më kujtohet Olympia.

Në këtë kohë siç e thash më lartë përveç asaj çka kisha dëgjuar e lexuar nga shkrimet në Kosovë, nga shtypi i Beogradit kisha lexuar për rolin kyç të Jusufit në organizimin e demonstratave në Evropën Perëndimore. Edhe lidhja e tij me Sabri Novosellën më jepte me kuptuar se ishim të së njejtës organizatë, Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ). Sa i përket gazetës Bashkimi, numri i parë i së cilës më kishte ra në dorë në Kosovë, në te dukej se nuk është gazetë e Lëvizjes së Jusufit. Liria, numri i parë i së cilës më kishte ra në dorë shihej gjithashtu se është i OMLK-së, megjithëse mua më kishte ra në dorë prej shokëve të Lëvizjes. Për Lajmëtarin e lirisë, revistën që në mënyrë të pakrahasueshme më kishte bërë përshtypjen më të madhe nuk dihej se kush qëndronte pas saj, as në pikëpamje organizative e as individuale.

-5. Unë e kam fajin

Pjesën më të madhe të mbrëmjes e kalova me Jusufin në studion e tij të punës në katin e tretë. Aty m'u dha rasti për herë të parë t'i shoh të gjithë numrat e gazetës Bashkimi, të Lajmëtarit të lirisë, dhe tre numrat e parë të Lirisë. Por ende pa më të treguar Jusufi për

punën e tij në këto gazeta, donte të dijë si ishin pritur nga rrethet e mia apo edhe nga populli në Kosovë. Pasi i thash disa fjalë për numrin e parë të Bashkimit, (pasi vetëm ai më kishte ra në dorë), për numrin e parë të Lirisë, më së shumti u ndala tek numri i parë i Lajmëtarit të lirisë.

Jusuf Gërvalla: Çka thuhet për Lajmëtarin e lirisë?

Xhafer Durmishi: Se është një diçka e jashtëzakonshme, se diçka e ngjashme nuk ka ra në duart e lexuesit në Kosovë kurrë më parë.

Jusuf Gërvalla: Po tjetër?

Xhafer Durmishi: Se pas tij mund të qëndrojnë Rexhep Qosja, Shukri Rahimi ose Jusuf Gërvalla?

Jusuf Gërvalla: Po pse unë?

Xhafer Durmishi: Sepse nga leximi rrjedh se ai që e ka shkruar Lajmëtarin është njohës shumë i mirë i Rilindjes dhe kolektivit të Rilindjes!

Jusuf Gërvalla: Kolektivin e Rilindjes dhe Rilindjen e njohin të gjithë intelektualët e Kosovës! Kosova është e vogël në këtë pikëpamje. Rilindja është e vetmja gazetë e përditshme!

Xhafer Durmishi: Se cilësia e lartë e përgatitjes dhe e letrës tregon se ka shumë mundësi që kjo ka qenë e mundur të bëhet vetëm në botën e jashtme!

Jusuf Gërvalla: Bota e jashtme është e madhe!

Xhafer Durmishi: Argumenti kryesor në supozimet rreth kësaj teme, tek të gjithë të interesuarit qëndron në pyetjen e tyre: Pse nuk doli Lajmëtari i lirisë para se me dalë Jusuf Gërvalla në Gjermani?

Jusuf Gërvalla: (pasi u mendua një cop herë) Unë e kam fajin. Nuk është dashur të bëjë përgatitjen teknike të Lajmëtarit në atë nivel. Do të kishte qenë më mirë të ishte përgatitur teknikisht më i thjeshtë në mënyrë që lexuesit të mendojnë se bëhet në Kosovë.

Vetëm pas fjalëve të tij "Unë e kam fajin" e kam marrë vesh se Jusufi qëndron pas Lajmëtarit të lirisë. Pas këtyre fjalëve ia bëra pyetjet:

Xhafer Durmishi: Pse e ke nxjerrë Lajmëtarin e lirisë pa e përmendur Lëvizjen, përderisa je anëtarë i saj? Apo pse nuk e ke nxjerrë në emër të Lëvizjes?

Jusuf Gërvalla: Në kohën kur sa e kam botuar Lajmëtarin (gusht 1980-janar 1981) nuk kam pasur kontakt me Lëvizjen. Sikur unë ta kisha bërë këtë punë kokë më vete, pa marrë leje prej udhëheqjes së Lëvizjes, ata kanë mund të më thonë se me kend u konsultove kur e bëre këtë punë?!

Xhafer Durmishi: Pse në vend të emrit Lajmëtari i lirisë, nuk e ke botuar me emrin "Zëri i Kosovës", ashtu siç shkruan në statut të Lëvizjes?

Jusuf Gërvalla: Përgjigja paraprake vlen edhe në këtë rast. Unë jo vetëm Lajmëtarin që nuk e kam nxjerrë në emër të Lëvizjes, por duke respektuar rigorozisht rregullat disciplinore unë aq më pak kam pasur të drejt me e nxjerrë "Zërin e Kosovës" kur nuk kam qenë në kontakt me udhëheqjen e Lëvizjes, dhe nuk e kam pasur një kërkesë të tillë prej saj. Si në rastin e Lajmëtarit ata kanë mund me të drejtë të më thonë: Me kend u konsultove dhe kush ta dha lejen apo të drejtën me e botuar "Zërin e Kosovës"?!

Xhafer Durmishi: Në Kosovë, më ka rënë ta lexoj një fletushkë me emrin "Zëri i Kosovës" që del në emër të Grupit komunist.

Jusuf Gërvalla: Personi që e nxjerr atë fletushkë quhet Riza Salihu dhe unë i kam shkruar Mërgimit-Sabri Novosellës, se emri "Zëri i Kosovës" nuk është i përshtatshëm për Lëvizjen tonë, sidomos për këtë arsye. Por Sabriu ka insistuar që ta nxjerrim organin "Zëri i Kosovës" si organ të Lëvizjes dhe kjo punë do të bëhet, nëse do të jetë e nevojshme, pasi nga ndihma ime për OMLK-në dhe bashkëpunimi me ta ka mundësi që gjërat të marrin një zhvillim interesant.

-6. Gazeta Bashkimi nuk del më!

Ai me tregoi edhe për punën e tij në gazetën Bashkimi.

Emrin e Ibrahim Kelmendit për herë të parë e kam ndie dhe lexuar në faqet e Ilustrovana Politikës së Beogradit dhe atë të përmendur e lidhur së bashku me emrin e Jusufit, me sa më kujtohet në maj të vitit 1981. Duke pasur parasysh këtë lansim të emrit të Ibrahim Kelmendit të lidhur me emrin e Jusufit, pa i ditur shkaqet e vërteta të lansimit dhe planet e UDB-së në këtë drejtim, kam pasur paramendime të mira. Jusufi më ka treguar numrat e revistës Bashkimi të cilat i ka përgatitur ai dhe mua më janë dukur aq të mirë sa që pyetjen e parë që ia kam bërë ka qenë:

Xhafer Durmishi: - Ku janë numrat tjerë pas janarit 1981?

Jusuf Gërvalla: - Gazeta Bashkimi nuk del më!

Xhafer Durmishi: - Pse?

Jusuf Gërvalla: - Ibrahim Kelmendi, personi që formalisht ka qëndruar pas Bashkimit nuk mundet me e nxjerrë në atë nivel në të cilin e kam ngritur unë, prandaj si duket **ai** apo **ata** kanë parapëlqyer më parë ta ndërpresin se sa të zbresin apo të përfundojnë në nivelin në të cilin i kam gjetur.

Unë nuk kam vazhduar me e pyet Jusufin për shkaqet e ndërprerjes së këtij bashkëpunimi duke e ditur se i ka arsyet e veta dhe do të më tregoj me kohë. Në muajt e parë, gjatë korrikut e gushtit Jusufi nuk ma ka thënë asnjë fjalë të keqe për I. Kelmendin por çka është edhe më interesante, nuk ma ka thënë as edhe ndonjë fjalë të mirë për te.

Jusufi më tregoi në vazhdim për bashkëpunimin e tij që muajt e fundit kishte pasur me OMLK-në, dhe si rezultat i ndihmës së tij për këtë organizatë ma tregoi numrin e tretë të revistës Liria, i cili pos tjerash edhe teknikisht dallohej shumë nga dy të parët. Kur Jusufi më ka treguar se si e ka botuar me mundin, talentin e dijeninë e tij Bashkimin, dhe numrin e tretë të Lirisë, unë si shokë i Organizatës së Jusufit kam ndier kënaqësi dhe krenari të madhe. E kam ndier veten kështu pasi kam menduar se nëse ndonjëherë do të ketë ndonjë gjest mirënjohjeje për punën e Jusufit për organizatat tjera, atëherë, edhe pse kjo ndihmë u është dhënë nga Jusufi si individ i LNÇKVSHJ, prapë se prapë ndoshta një pjesë e vogël e nderit do t'i bien hise jo vetëm Lëvizjes së tij por edhe mua si anëtar i saj. Ia kam pasur lakmi Jusufit në këtë punë, dhe sikur organizatat tjera do të më drejtoheshin mua për ndihmë në atë kohë dhe sikur t'i kisha pasur dhuntitë që natyra ia kishte dhënë Jusufit, ndoshta edhe unë do të kisha vepruar si ai. Por gjërat nuk janë zhvilluar në këtë formë për mua, dhe përveç Lëvizjes së Jusufit askush tjetër nuk ka pasur nevojë për punën time. Përkundër lakmive të mia të mëdha, jam detyruar të kënaqem me atë që natyra ma ka caktuar.

4. TRUPROJË APO TURPROJË

Të dielen pas dite unë dhe Haxhi Berisha e morëm trenin dhe shkuam në banesën e tij, në një dhomë të konviktit të studentëve në periferi të Ludvigsburgut:

Studentenwohnheim, Eduard-Spranger-Straße 7, 71634 Ludwigsburg

Me ndonjë ndërprerje të vogël unë dhe disa shokë banuam në këtë konvikt, në dhoma të ndryshme të katit të 10-të, prej korrikut 1981 deri në korrik 1982.

Para se të niseshim me Haxhiun për në Ludvigsburg, unë i mora nga Jusufi të gjithë numrat e të gjitha gazetave që ishin botuar gjer atëherë dhe brenda tri-katër ditëve në vazhdim i lexova dhe studiova ngadalë që të gjitha. Gjatë ditëve të para ditën e kaloja më shumë në zyrën e Bardhoshit. Pas dy tri ditëve erdhi Jusufi dhe qëndroj në konvikt ku banoja gati gjithë ditën. Naimi e Haxhiu, sigurisht ia kishin përcjellë vëmendjen time në leximin dhe studimin e revistave, dhe kjo i kishte bërë përshtypje Jusufit. Ç'është e vërteta, unë jo vetëm si lexues i largët, por edhe pasi isha njohur personalisht me Jusufin, respektin që e kisha pasur kur i kisha lexuar shkrimet e tij nga distanca e ruaja edhe tani kur bisedonim nga afër për të gjitha gjërat që kishin të bënin me luftën tonë. Me sa mund ta kuptoja kjo nuk kishte ndodhë tek të tjerët. Naim Haradinaj kishte futur në Kosovë Bashkimat e përgatitur nga Jusufi dhe Lajmëtarin e lirisë, por në leximin e tyre nuk kishte investuar aq kohë e interes sa u kisha kushtuar unë. Kjo vlente edhe për të tjerët. Fitohej përshtypja se këta, duke pasur rastin të qëndrojnë pranë Jusufit për muaj e me vite mendonin se të gjitha fjalët që Jusufi i kishte shkruar në gazeta e revista, në mënyrë të pashmangshme ua kishte transmetuar këto fjalë atyre edhe gojarisht, dhe mu për këtë shkak ata nuk kishin nevojë me e pi të njejtin ujë prej shisheve plastike apo ujësjellësit, të cilin fillimisht e kishin pirë nga kroi i malit respektivisht drejtpërdrejtë nga burimi.

Gjatë të premtes së radhës Bardhoshi na mori në Ludvigsburg ne që ishim në konvikt dhe shkuam në Untergruppenbach. Jusufi më kishte porositur që të hedhi në letër disa mendime të miat lidhur me demonstratat e Pranverës 1981 në Kosovë, në disa faqe. Këtë punë unë e kisha të kryer, dhe ai u nda shumë i kënaqur prej shënimeve të mia. Gjatë këtij vikendi të parë dhe në ditët në vazhdim, më ra rasti ta takoj atë që ishte bërthama e shokëve të Shtutgartit prej 7-8 vetash, megjithëse në ato momente të takimeve të para nuk isha krejtësisht i vetëdijshëm për këtë. Atë të shtune e të diele, dhe më vonë, individualisht apo në grupe të vogla, për herë të parë më ra rasti të takoj Remzi Ademin, Faridin Tafallarin, Nami Ramadanin, Mejdi Rexhën, Ismet Klaiqin, Nuhi Sylejmanin, Shaban Bobajn, Selim Kocën, Selim Dullën, Sefedin Tafallarin, Kolë Mërturin, Murat Kryeziun e ndonjë tjetër. Një përshkrim më i plotë me aktivistët e rrethit të Shtutgartit dhe emrat e atyre që e kanë ndihmuar luftën në çdo mënyrë gjendet në librin "Lëvizja e Jusuf Gërvallës" dhe librat tjerë të mi, të botuar gjatë vitit 2012. Ky ishte rrethi i punëtorëve, pikëmbështetja kryesore e Vëllezërve Gërvalla. Përveç këtyre ishte një rreth më i vogël i të "papunëve", "papunëtorëve", të rinjve në të cilin ishin Haxhi Berisha, Naim Haradinaj, Hafiz Gagica, Agron Sela e Hysen Spahiu. Në këtë grup "badihavxhinjsh", të cilët Vëllezërve Gërvalla "u silleshin nëpër këmbë" apo në të cilët ata "kah të silleshin merrnin në thue" më duket se i plotësoja disa prej kushteve që të jem edhe unë.

Nga 14 dhjetori 1979 deri në mesin e korrikut 1981 kishin kaluar rreth 19 muaj që Jusufi ishte larguar nga Kosova, dhe me këta shokët e lartpërmendur ishte njohur për një kohë të gjatë, apo aq të gjatë, sa i kishin zbrazur bukur shumë thasët e muhabeteve në mes veti. Për këtë shkak, duke u bazuar në atë çka kishte ndodhë në Kosovë disa muaj më parë Jusufi ishte i interesuar që para këtyre shokëve të ma jep fjalën, që ta qes rendin tim, shumë më tepër se sa të mos kishin ndodhur demonstratat. Raporti im që ia kisha

dhënë Jusufit me shkrim ia jepte atij një siguri dhe ai nuk kishte frikë se gjatë tregimit të ngjarjeve do të shkretoja ndokund.

Gjatë këtij vikendi të dytë të qëndrimit tek Jusufi, ai më tregoi për disa gjëra më konkrete që ua kishte përcjellë Sabri Novosella për mua. Sabriu më kishte takuar gjatë tri ditëve qëndrimi e bisedash intensive në fillim të janarit 1981, në banesën e Tefik Strajës, në lagjen Pendik të Stambollit. Duke e bazuar në përshtypjet nga takimi i atyre ditëve ai më kishte porositur të shkoj në Shtutgart, dhe unë veprova sipas porosisë së tij. Ka mundësi që ai mund ta ketë tepruar sa i përket përshkrimit të aftësive, prirjeve dhe personit tim në përgjithësi. Në një mënyrë apo tjetër, me gojë ose me shkrim, Sabriu i kishte thënë Jusufit se Xhafer Durmishi vet apo me aftësitë e tij organizative duhet të merret me çështjen e truprojës tënde (Jusuf Gërvallës). Jusufi nuk foli gjatë me mua në këtë pikë por shkurtimisht m'i tha disa fjalë që ia kishte përcjellur Sabriu. Jusufi, pasi më kishte takuar tërë vikendin e parë në shtëpinë e tij, (17-19 korrik 1981), një ditë në Ludvigsburg (në mes të javës) dhe tani në vikendin e dytë (24-25 korrik 1981) ma shprehi mendimin e tij, se primare për jetën e tij është ruajtja e luftës sonë dhe Lëvizjes sonë nga TURPI, sepse në luftë ka njerëz që nuk zgjedhin asnjë mjet, e cila është një çështje më afatgjate apo e përjetshme, ndërsa çështja e ruajtjes së TRUPIT është çështje e dorës së dytë, është çështje kur edhe ata që kanë pasur ushtri të mëdha në këtë drejtim e mekanizma shumë të sofistikuar kanë pasur vetëm suksese të përkohshme, dhe nuk ekziston deri më sot asnjë krijesë njerëzore që ia ka dalë ta ruaj trupin përtej një intervali të caktuar kohor. Çështje tjetër është se në këtë mesin e shokëve këtu janë disa që janë shumë më të përshtatshëm se sa ti për truprojë. Se çfarë aftësish mund të fshihen tek ti do ta shohim bashkarisht. Por një mendje ma thotë, koha le ta tregoj se sa kam të drejtë, por unë do të isha shumë i kënaqur nëqoftëse ti në momentin e duhur, në momente të caktuara, do të bëheshe TURPROJA e Lëvizjes sonë, TURPROJA e luftës sonë të përbashkët. Nëse ti e kryen këtë detyrë, nëse situata e kërkon, atëherë ti e ke kryer detyrën që ta kanë dhënë shokët e Lëvizjes sonë.

Disa ditë pas vendosjes sime në Ludwigsburg ka ardhë Kadri Zeka tek Jusufi dhe i ka sjellur materialet e Lirisë për numrin 4-5, të cilat pastaj vetë Jusufi e ka ditur se si duhet ta përfundojë. Unë nuk e kam takuar atë në këtë rast, por se i ka sjellë materialet më ka tregue Bardhi në banesën, ku banoja me Haxhi Berishën e Naim Haradinajn, në Ludwigsburg.

5. TEORIA DHE PRAKTIKA

Teorikisht, në parashtrimin e argumenteve dhe propagandës Jusufi qëndronte mbi të gjithë aparatin dhe kalemxhinjtë e Lidhjes Komuniste të Kosovës. Me një fjalë, në pikëpamje teorike, me anë të revistave të tij, ai i kishte mundur, i kishte deklasuar tërësisht. Por në praktik gjërat nuk e përcjellin hap mbas hapi teorinë. Në të vërtetë filleve të organizimit praktik u paraprinë një ide e cila duhet të zotërohet në gjitha pikëpamjet. Tani pas tri dekadash, kur vepra e Jusufit është duke u bërë e njohur në të gjitha dimensionet e saj, shumë lehtë krijohet iluzioni se autoritetin e sotëm që Jusufi e Bardhoshi e kanë në botën shqiptare, e kanë pasur edhe nga dhjetori 1979 deri në janar 1982. Por kjo nuk është e vërtetë. Në atë kohë Jusufi e Bardhoshi kanë qenë të njohur, personalisht vetëm për një rreth të ngushtë në Shtutgart.

Jusuf Gërvalla: *"Konkretisht në rrethinën e Shtutgartit janë nja 7 – 8 shokë të gatshëm e të përshtatshëm për punë patriotiko-revolucionare. Ata presin ndonjë orientim nga unë. Po unë duke qenë dhe vetë në mjegull për gjendjen time, nuk kam dashur t'i*

ngashënjej e pastaj t'i lë në gjysmë të rrugës. Prandaj u kam folur për gjëra të përgjithshme në çështje të organizimit, të propagandës dhe të agjitacionit si dhe kam bërë përpjekje për t'ua dhënë elementet e domosdoshme shkencore të historisë kombëtare dhe të lëvizjes komuniste shqiptare e ndërkombëtare. ***Janë punëtorë*** *dhe ma ka marrë mendja se në radhë të parë u duhet një ngritje e tillë ideore, politike e shkencore."* (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981)

Jusuf Gërvalla: *"Deri më tash, nga punëtorët kosovarë në mërgim, përmes meje kanë hyrë në Lëvizje 7 shokë. Secili prej tyre ka rrethin e vet, në të cilin ushtron ndikim dhe zhvillon veprimtari agjitative e të cilin e furnizon me materiale. Ata janë aktivë dhe me ndihma materiale të nevojshme, por kam pasur kujdes që të mos ngarkohen tepër. Këta njerëz kanë qenë aktiv, pos të tjerash, edhe në tubimin sa më të madh të punëtorëve për demonstratat tona në botën e jashtme."* (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

Këta 7–8 punëtorë apo dhjetë, së bashku me 4-5 vetë tjerë të rinj, të cilët nuk kishin leje të përhershme pune e as qëndrimi në Gjermani, janë të vetmit që pa diskutim e kanë pranuar Jusufin si udhëheqës të çështjeve praktike dhe teorike, që nga ai kanë marrë detyra të rregullta dhe e kanë pranuar edhe si udhëheqës shpirtëror, që nga ai kanë pranuar ndikime të asaj shkalle të cilat kanë ndikuar në rrjedhat, e kahjet e tërë jetës së tyre. Sot ka gënjeshtra nga më të paskrupulltat se sa i madh na del numri i atyre që e kanë njohur dhe kanë pasur bashkëpunim politik të ngushtë me Jusufin, sidomos në Gjermani apo Evropë. Jusufin nuk e kanë pranuar aktivistët e dalluar, si udhëheqës në Gjermaninë veriore e as në Zvicër. Por në atë kohë, kjo nuk ka qenë punë me të cilën e lodhë veten Jusufi. Si njeri që është marrë në radhë të parë me luftën propagandistike e me teori ai nuk ka mundur që në të njejtën masë t'u kushtoj vëmendje aktiviteteve praktike, por në këtë drejtim u ka lënë hapësirë të tjerëve që ata ta kryejnë atë punë për të cilën janë të prirur më shumë.

Se çka ka menduar Ibrahim Kelmendi për Jusufin dhe rrethin e tij në Shtutgart, shihet qartë në librin e tij Atentatet dhe në atë të Bedri Islamit "Lëvizja". Se çka ka menduar Partia Komuniste (PKMLSHJ), - Abdullah Prapashtica, për Jusufin dhe rrethin e tij në Shtutgart, shihet në librin e "Vrasja e trefishtë" të nënshkruar nga Nuhi Sylejmani. Se si e kanë parë udhëheqësit e OMLK-së punën e Jusufit në raport me OMLK-në, shihet në librin e Mehmet Hajrizit "Histori e një organizate...", Apostol Dukës "Vrasje në Shtutgart", në përmbledhjen e Rasim Selmanajt "Heroi me kitarë" dhe në shkrime tjera.

Raportin e Jusufit me këto rrethe të jashtme e kam shqyrtuar tërësisht në librin "Lëvizja e Jusuf Gërvallës", tetor 2011 dhe këtu nuk kam nevojë të ndalem. Ajo çka është me shumë rëndësi, është se roli dhe pesha e Jusuf Gërvallës nuk pranohet ashtu siç ka qenë në të vërtet as nga ata që janë marrë me shkrimin e historisë së LNÇKVSHJ, nga radhët e brendshme të saj, si në Kosovë apo jashtë: Libri i Selatin Novosellës "Metush Krasniqi" e vërteton këtë më së miri. Por libri i Selatin Novosellës nuk do ta kishte shkëlqimin e vetë në tërë këtë godinë sikur t'i mungonte kulmi, sikur të mungonin qëndrimet e disa pjesëtarëve të familjes së Jusufit.

6. Punëtorët dhe të papunëtorët

Kur në një rreth, nuk është çështje që diskutohet se kush është udhëheqësi, kush është i pari, kush e ka fjalën kryesore, shumë gjëra qartësohen, shumë energji nuk derdhen për diskutime të kota e grindje. Megjithatë ndonjë qetësi e madhe nuk vendoset, sidomos nëse rrethi është i gjerë. Në rastin tonë, rrethi i Jusufit nuk ishte madh. Rrethi nuk ishte i madh, sa të ishte nevoja me u bërë ndonjë diferencim se cili është rrethi më i ngushtë e cili është rrethi i gjerë, cili është shoku më i ngushtë e cili më i gjerë, cili është shoku më

shpirtngushtë e cili më shpirtgjerë. Secili prej nesh kishte kontakt të drejtpërdrejt me udhëheqësin, me Jusufin. Nuk ka ndodhur në asnjë rast që Jusufi t'i dërgonte fjalë apo porosi dikujt përmes një tjetri. Këtë ai do ta bënte me siguri më vonë, kur punët do të zgjeroheshin, por me atë grup të ngushtë shokësh kjo nuk ka qenë e nevojshme.

Në mesin e punëtorëve, në mesin e atyre që e kishin të rregulluar çështjen e qëndrimit dhe lejen e punës në Gjermani, siç e kam potencuar më heret ishin Remzi Ademi nga Zhuri, i cili banonte në Brackenheim, gjeografikisht apo fizikisht, së bashku me Selim Dullën banonin më së afërmi prej Untregruppenbachut, dhe në ditët e para më ka rënë me i takuar më së shpeshti. Përmes Jusufit e kam njoft edhe Kolë Mërturin. Nami Ramadani nga fshati Tenovë i Tetovës jetonte në Eslingen. Punonte si shofer kamionësh në relacione të gjata. Kishte shpërndarë revistat e Jusufit gjatë udhëtimeve të tij nëpër qendra të ndryshme. Rruga e sillte shpesh të kalonte përmes autostradës së Heilbronit dhe të shumë e herë në këto raste, në planifikimin e rrugës së tij, pushimin e radhës e caktonte ta bënte në Untergruppenbach. Mejdi Rexha dhe Shaban Bobaj ishin nga Korisha dhe punonin në Fabrikën e Mercedesit në Sindelfingen. Po në këtë fabrikë punonin Nuhi Sylejmani nga fshati Stanec, Ismet Klaiqi nga komuna e Dardanës, Selim Koca nga Polaci, Abdurrahman Sadiku nga Dumnica e Llapit. Vëllezërit Sefedin dhe Faridin Tafallari vinin nga Stuzhja e Prizrenit. Faridini me familjen e tij banonte në Nagold.

Ky ishte rrethi i punëtorëve, dhe së bashku me disa të tjerë ishin pikëmbështetja kryesore e Vëllezërve Gërvalla.

Përveç këtyre ishte një rreth më i vogël i të "papunëve", "papunëtorëve", të rinjve në të cilin ishin Haxhi Berisha, nga Prapaqani që kishte lidhje familjare të hershme me familjen e Jusufit. Haxhiu kishte hyrë shumë herë me revistat e Jusufit ilegalisht në Kosovë. Naim Haradinaj nga Gllogjani, i biri i Ismail Haradinajt, më duket se në Shtutgart në rrethin e Jusufit ishte nga vera e vitit 1980. Naimi ishte ai që e kishte futur Lajmëtarin e lirisë në Kosovë. Agron Sela nga Dibra me rrethin e Jusufit me sa më kujtohet kishte ra në kontakt përmes Naim Haradinajt, me të cilin ishte njohur në Prishtinë. Hysen Spahiu nga Dibra njihej me Agronin. Hysenin e Agronin i kam gjetur në Shtutgart dhe nuk e di se sa kohë para meje kanë qenë në atë rreth. Hasan Rrahmani nga Dumnica e Llapit, është i vetmi që ka ardhur në rrethin e Jusufit pas meje. Hasani erdhi në Shtutgart në rrethin tonë përmes Sabri Novosellës. Hafiz Gagica e kishte babain Sinanin i cili prej vitesh punonte në Ludvigsburg. Ai jetonte në banesën e babait dhe ishte njohur me Bardhoshin së pari e pastaj edhe me Jusufin. Në këtë grup "badihavxhinjsh", të cilët Vëllezërve Gërvalla "u silleshin nëpër këmbë" (me përjashtim të Hafizit) apo në të cilët ata "kah të silleshin merrnin në thue" më duket se i plotësoja disa prej kushteve që të jem edhe unë.

Në këtë grup, asnjëri nuk e kishte të rregulluar në mënyrë të përhershme çështjen e qëndrimit dhe të lejes së punës. Ishim ndodhur aty për shkak të aktiviteteve politike, kush më shumë e kush më pak, disa para demonstratave të 1981 e disa menjëherë pasë tyre.

Të gjithë ne, në rrethin e Jusufit ishim krenar që i takonim atij rrethi, por më duket se disa nga rrethi i punëtorëve ishin më krenar dhe kishin argumente më të shumta se ata janë më të dobishëm për Jusufin se sa ne të papunët. Megjithatë ndonjë kontradiktë, apo ndonjë konflikt serioz, i dukshëm apo i padukshëm në mes punëtorëve dhe të papunëve nuk ekzistonte, me ndonjë përjashtim të vogël. Ato ditë, një kohë pas arritjes sime në Shtutgart Jusufit i erdhi, FJALORI I GJUHËS SHQIPE, libri më voluminoz, në një vëllim, që e kisha parë në gjuhën shqipe. Nuhi Sylejmani posa e sheh këtë fjalor i thotë Jusufit se është mirë me i marrë këta të rinjtë dhe në ato kohë që nuk kanë punë në fabrika e restorante, t'i ndajnë në marrëveshje me njëri-tjetrin, në mënyrë të barabartë, secili fjalët e një germe të caktuar të alfabetit, p.sh. Agroni t'i studioj të gjitha fjalët prej germës A-E,

Haxhiu prej F-H, e kështu me radhë. Këta e kanë detyrë me i analizuar, me shikuar se a mungojnë fjalë të caktuara që përdoren nga populli në rrethe të caktuara, të mbajnë shënime dhe në një mbledhje në të ardhmen t'a dorëzojnë punën e tyre me shkrim. Po që se e kryejnë këtë detyrë, ndoshta ia vlen me humbë kohë me ta, nëse jo, vërtetohet dyshimi im se këta përtaca me i mbytë me bukë në gojë në qafë nuk i merr. Pjesërisht këto fjalë i kisha dëgjuar edhe vet prej Nuhiut. Por Jusufi m'i tregonte në formë më të kompletuar.

Në këtë kuptim qëndrimi i Nuhiut ishte një lloj përpjekje për të na bindur në mënyrë autoritative se qëndron më së afërmi nga Jusufi dhe se ishte krahu i tij i djathtë në raport me ne të rinjtë. Por kjo nuk është krejtësisht e vërtetë, sepse Nuhiu bënte një luftë shumë më të ashpër dhe më të pamëshirshme edhe ndaj vetë punëtorëve e shokëve me të cilët punonte në fabrikë. Thelbi i luftës së tij, dhe çka e dallonte atë në mendjemprehtësi ishte ky:

Ndonjë të shtune vinte Nuhiu me Mejdi Rexhën, Ismet Klaiqin, Shaban Bobajn apo Selim Kocën tek Vëllezërit Gërvalla në Untergruppenbach. Rrinin sa rrinin duke bërë biseda në atë atmosferë që vetëm Jusufi e Bardhoshi mund ta krijonin. Kur vinte koha për të dalë, dilnin ata shokë që kishin ardhë me një kerr të caktuar. Kështu dilte Nuhiu me shokët me të cilët kishte ardhur. Pak para se me hy në kerr, atij (Nuhiut) i binte ndërmend se ka harruar diçka pa marrë në banesë të Jusufit dhe me shpejtësi kthehej prapë. Hynte në shtëpi duke kërkuar gjoja sendin "e harruar", i ndërronte edhe disa fjalë me Jusufin tek dalja, duke qeshur, dhe shkonte e i bashkohej shokëve me të cilët kishte ardhur. Këta trika fenomenal Nuhiu i kishte vu në sistem. Qëllimi i tij ishte me u tregua shokëve të vetë të cilët e kishin pru, se iu dashtë me u kthye prapë e me i ndërrua disa fjalë me Jusufin, disa fjalë të cilat Jusufi nuk pati mundësi me ia thënë atij para të gjithëve, por e ruajti rastin kur të mbetet vetëm me te. Edhe pse e panë të tjerët e panë se mbeti vetëm me Nuhiun, asnjëri nuk pati mundësi ta dëgjoj se çka i tha. Konkluzioni: Jusufi ka një lidhje, një besim, një afërsi me Nuhi Sylejmanin që nuk e ka me të tjerët. Jusufi e dinte mirë këtë lojë, ne të rinjtë e dinim mirë këtë lojë të tij, shokët e vetë e dinin mirë këtë lojë. I vetmi që besonte në këta trika qesharak, që i bënte të gjithë të qeshin ishte vetëm autori i tyre Nuhi Sylejmani.

Në raste kur bisedoja me Jusufin për çështje të ndryshme, ku përgatisnim revistën Zëri i Kosovës, binte fjala edhe për shokët tjerë, dhe unë e pyeta njëherë për Faridinin. Jusufi më tha: *Faridin Tafallari është kallap burri*, ndërsa për Nuhi Sylejmanin u shpreh: *Nuhiu është njeri me xhepa*, (d.m.th. me shumë xhepa, me fjalë tjera me shumë fytyra). Fjalët e përshkrimet e Jusufit të asaj bisede nuk do t'i harroja kurrë. Në ditët pas 17 janarit 1982, Faridin Tafallari që banonte më së largu prej Untergruppenbachu dhe Remzi Ademi që banonte më së afërmi, ishin shtyllat e lisat kryesor në të cilët u mbështetëm ne të rinjtë e pa rrënjë.

7. KOMUNIKATA E LËVIZJES SË JUSUF GËRVALLËS PËR DEMONSTRATAT E VITIT 1981

Enver Hoxha: *"Dolanci po ashtu tha se "i njohim cilët janë organizatorët. Ata janë në Shtutgart, në Bruksel dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës". Ai tha po ashtu se, gjoja në demonstratë ishte një numër i vogël të gënjyerish.*

Kur zoti Dolanci i njihte organizatorët se ishin në Shtutgart e gjetkë nëpër Evropë, përse nuk i neutralizoi?" (Ditar për çështjet ndërkombëtare, 1980-1981, Vëllimi 13, faqe 387, Tiranë 1985)

Fjalët e mësipërme Enver Hoxha i shënon në ditarin e tij, më 17 prill 1981, që mbajnë titullin "ARSYET E VËRTETA TË GJENDJES DHE TË NGJARJEVE TË KOHËVE TË FUNDIT NË JUGOSLLAVINË TITISTE", me shpjegimin përkatës: Këtë material autori e ka përdorur në artikullin me titull "Kush e nxit armiqësinë midis popujve në Jugosllavi?", ("Zëri i popullit", 23 prill 1981).

Jo vetëm Stane Dolanci e Enver Hoxha flasin për Jusuf Gërvallën, *organizatorin e Shtutgartit*. Menjëherë pas demonstratave, gazetar të gazetave prestigjioze gjermane e kontaktojnë Jusuf Gëvallën dhe ia shtrojnë pyetjen: A je ti organizator apo ndër organizatorët e demonstratave. Jusufi u përgjigjet në emrin personal se nuk është organizator i demonstratave.

Në fillim të korrikut 1981 unë, nga Zvicra - ku ndodhesha atëherë, marrë kontakt me Jusufin e Bardhoshin, përmes Sabri Novosellës. Kontaktet e mia telefonike me Bardhoshin, në zyrën e tij në Ludvigsburg, prej fillimit të korrikut e deri më 16 korrik janë gati të përditshme dhe një prej temave kryesore të bisedimeve tona kanë qenë demonstratat e Pranverës 1981. Biseda me përmbajtje të ngjashme kam bërë nga Zvira edhe me Sabri Novosellën në Turqi.

Në Shtutgart - Untergruppenbach mbërrij në mbasditën e 17 korrikut 1981. Në rastin e parë Jusufi, bisedon me mua rreth mendimeve të mia rreth demonstratave dhe unë në mënyrë edhe më të përmebledhur ia them ato që ia kisha thënë në ditët e mëparme Bardhoshit përmes telefonit. Deklarata e Komitetit Qendror, kam menduar se është bërë në fillim të gushtit 1981. Letra e mëposhtme e Jusufit e vërteton se ajo është shtypur botuar rreth 21 korrikut. Letra e Jusufit e bënë një precizim kohor. Ka qenë bindja ime e thellë se Jusufi është bazuar në raportimin tim rreth çështjes së organizimit të demonstratave në Kosovë, bazim i cili ju ka dukur aq solid sa ai ka mund të deklrarohet dhe t'u jap përgjigje të gjithëve: shokëve të Lëvizjes, organizatave tjera shqiptare, shtetit shqiptar, shtetit jugosllav dhe opinionit ndërkombëtar. Kjo besueshmëri e Jusufit në raportimin tim ma ka dhënë të drejtën të thirrem në kontributin tim në këtë pikë, dhe qëndrimin tim e konsideroj dobishëm për të vërtetën, për Lëvizjen dhe për të gjithë të involvuarit.

Jusuf Gërvalla: "*Deklarata e KQ dedikuar shtypit të Perëndimit është shtypur shqip, gjermanisht e serbokroatisht. Të parët që e kanë botuar në organet e tyre janë kroatët e mërguar. Kështu ka ndodhur një e pa mirë që nuk e parashikonim. Por, shpresojmë se do ta publikojnë edhe të tjerë."* (Letër Sabri Novosellës, 21 korrik 1981)

K O M U N I K A T E
e Komitetit Qendror
të LEVIZJES NACINALÇLIRIMTARE TE KOSOVËS

Për të fshehur shkakun e vërtetë të demonstratave dhe trazirave të sivjetme në Krahinën e Kosovës, skamjen e mjerimin, shtypjen nacionale, sociale e kulturore të popullsisë vendëse, qeveria shoviniste e Beogradit, me kryepolicin Herleviç në krye, u

hodh në të katër anët për të kurdisur arsye të paqena, si ”romantizëm nacional” dhe ”nacionalizëm e shovinizëm shqiptar” si dhe për të gjetur ”organizatorin” e demonstratave, duke fajësuar her një ”grup huliganësh”, herë ”ekstremistët” shqiptarë, (duke pasur në këtë rast parasysh Marksistë-Leninistët e Kosovës) herë organizatën Fronti i Kuq Popullor etj., në mënyrë që pastaj të kthehet e t’ia ngarkoj fajin kryesor Republikës popullore Socialiste të Shqipërisë.

Ndër ”organizatorët” e shumtë, kryepolici Herleviç, zuri ngoje edhe organizatën tonë patriotiko-revolucionare me emrin Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës, duke e fajësuar atë për shumë ”vepra” që nuk përkojnë aspak me veprimtarinë e saj.

E kemi parë të udhës që pasi, pasi në mjetet e informimit publik të Perëndimit u publikuan ”informatat” e përpunuara nga agjencitë gazetare jugosllave, t’ju drejtohemi me një kërkesë demokratike edhe ne: për dezinformimet e ndryshme rreth ngjarjeve tragjike të Kosovës; ne do të kishim pasur një satisfaksion, po që se do ta transmetoni në organet tuaja edhe këtë komunikatë nga ana e Komitetit Qendror të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës.

1. Demonstratat e Kosovës të këtij viti nuk i ka organizuar LNÇK. Ato kanë shpërthyer spontanisht, së pari në Universitetin e Kosovës, e pastaj janë përhapur në të gjitha viset e Kosovës. Shkaku dhe arsyeja e shpërthimit të tyre nuk mund të kërkohen askund tjetër, pos në revoltën e grumbulluar me dhjetëra vite te popullsia shqiptare për shkak të skamjes, mjerimit dhe padrejtësive nacionale që i bëhen popullit tonë nga ana e qeverisë shoviniste të Beogradit.

2. Kërkesa për t’iu njohur Kosovës statusi i republikës së federuar jugosllave nuk është kërkesë e LNÇK. Organizata jonë lufton për çlirimin e tokave shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia dhe bashkimin e tyre me vendin amë, Shqipërinë, dhe kështu për krijimin e shtetit unik shqiptar brenda kufijve kombëtarë. Kjo shihet nga Statuti dhe Programi, nga të gjitha dokumentet e LNÇK të botuara në organet ”Zëri i Kosovës” dhe ”Lajmëtari i lirisë”, si dhe në të gjitha traktet tona.

Kërkesa për republikën e Kosovës është kërkesë e një pjese të intelegjencies së Kosovës. Çështja e saj është shtruar më heret, sidomos më 1968. Pasi ajo u refuzua nga ana e Titos dhe e qeverisë jugosllave, në Kosovë patën shpërthyer në nëntor të vitit 1968 demonstrata të fuqishme. Edhe atëherë edhe sot, kjo kërkesë u përkrah nga mbarë populli shqiptar në Jugosllavi. Por, LNÇK mbetet pranë kërkesës së saj të vetme – luftës për bashkimin e ligjshëm të të gjitha trojeve shqiptare të robëruara nga Jugosllavia dhe bashkangjitjen e tyre shtetit amë.

...Në fund ju njoftojmë se Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës është një organizatë patriotiko-revolucionare që lufton me mjetet më demokratike që janë përdorur ndonjëherë në Evropë. Terrori, anarkia e revanshizmi kanë qenë dhe mbeten metoda, jo vetëm të huaja por edhe të urryera e rreptësishtë të ndaluara për çdo anëtar dhe simpatizant të Lëvizjes sonë."

Kjo komunikatë u përpilua me shkrim nga Jusuf Gërvalla dhe nga të dhënat e Xhafer Durmishit, në korrik 1981, dhe u nënshkrua Komiteti Qendror i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës.

Kjo është e vetmja Komunikatë që e ka lëshuar LNÇKVSHJ. Në pikëpamje organizative, në këtë rast e shoh të arsyeshme ta bëjë një koment të vogël, kur është në pyetje Lajmëtari i lirisë. Të shohim këtë pjesë të Komunikatës:

"Kërkesa për t’iu njohur Kosovës statusi i republikës së federuar jugosllave nuk është kërkesë e LNÇK. Organizata jonë lufton për çlirimin e tokave shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia dhe bashkimin e tyre me vendin amë, Shqipërinë, dhe kështu

për krijimin e shtetit unik shqiptar brenda kufijve kombëtarë. Kjo shihet nga Statuti dhe Programi, ***nga të gjitha dokumentet e LNÇK*** *të botuara në organet "Zëri i Kosovës" dhe "****Lajmëtari i lirisë****", si dhe në të gjitha traktet tona."*

Gjatë kohës kur Jusufi e ka botuar Lajmëtarin e lirisë, për shkak se nuk ka pasur lidhje me udhëheqjen e LNÇKVSHJ, ai nuk e ka përzier apo identifikuar Lajmëtarin si revistë apo dokument të Lëvizjes.

Jusuf Gërvalla: *"Madje nga njoftimet që zunë të më arrijnë pastaj për riorganizimin e kujdesshëm të atij grupi (të Deçanit, të Ismail Haradinajt-shën i Xh. D.), mora impulse edhe për ta nxjerrë vetë (me përballime të mëdha materiale e pa bashkëpunëtorë) edhe revistën e përdymuajshme "Lajmëtari i lirisë", tre numrat e parë të së cilës po t'i dërgoj me këtë udhë."* (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981)

Me anën e kësaj letre pra për herë të parë Sabri Novosellës i dërgohen dhe i bien në dorë tre numrat e revistës Lajmëtari i lirisë, që i dërgohen nga Jusufi, ndërsa për ekzistimin e Lajmëtarit të lirisë, Sabriun e pata njoftuar kur isha tek ai në Stamboll në janari 1981.

Jusuf Gërvalla: "***Gjëja më e rëndësishme lidhur me "Lajmëtarin" është se, duke qenë krejt i vetmuar, nuk e mora dot guximin ta emëroja atë si organ të LNÇKVSH. Kjo është e vetmja arsye pse në të nuk flitet e brohoritet në emër të Lëvizjes sonë.*** *Mjafton ta përmend faktin se dy materialet e Lëvizjes, që i botova në numrin 3, i lëshova me njëqind druajtje, ngase nuk isha në gjendje të gjykoja vetë dhe të fitoj bindjen e plotë se a bëja mirë apo keq."* (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981)

Jusuf Gërvalla: *"„Lajmëtari i lirisë", ashtu si propozoni ju, mund të dalë si organ i Rinisë së LNÇKVSHJ, po do të jetë ngarkesë për forcat tona njëherë për një herë të pakta krijuese këndej. Por, edhe lidhur me këtë, ne do të punojmë ashtu si e do puna, dmth. si na porositni ju."* (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

Pas marrjes së kontaktit me Sabri Novosellën në mesin e prillit 1981, kur kritikohet e i thuhet se është dashur që Lajmëtari të dalë në emër të Lëvizjes, Jusufi për ta dëshmuar lojalitetin e tij të parezerva ndaj organizatës së vet ia dedikon, (apo e identifikon Lajmëtarin e lirisë), Lëvizjes së tij Nacionalçlirimtare, me anën e fjalisë: . *"Kjo shihet nga Statuti dhe Programi,* ***nga të gjitha dokumentet e LNÇK*** *të botuara në organet "Zëri i Kosovës" dhe "****Lajmëtari i lirisë****", si dhe në të gjitha traktet tona."*

Shtypja e Komunikatës së Lëvizjes Nacionalçlirimtare u bë me atë makinë shkrimi me të cilën ishin radhitur numrat 2-3 të Lajmëtarit të lirisë dhe 3 dhe 4-5 të revistës Liria.

8. PËRGATITJET PËR BOTIMIN E *ZËRIT TË KOSOVËS*

Jusuf Gërvalla: *"Ne patëm një vërejtje konkrete: autorizimi i çdo dege të Lëvizjes për të nxjerrë nga një organ të vetin me titull „Zëri i Kosovës" na duket jo i dobishëm, por i dëmshëm. Ai nuk do të flasë për unitetin, por për copëzimin e Lëvizjes, jo për forcën po për anarkinë brenda për brenda Lëvizjes. Nuk është çudi, pos të tjerash, që në këtë rast nga organi i një dege të dalin në shesh pikëpamje e mendime të kundërta me ato të degës tjetër, skajore. Të mos flasim për nivelet në realizimin e tyre. Nevoja për nxjerrjen e tyre bëhet, sipas mendimit tonë, aq më e përjashtueshme, pasi tash po del një organ qendror publik, me tirazh të madh, me materiale të bollshme e me përgatitje përkatëse teknike. Ka qenë e udhës që forcat krijuese dhe mjetet materiale të nevojshme për nxjerrjen e organeve nga ana e çdo dege, të centralizohen dhe t'ia japin krahun e tyre organit qendror."* (Letër Sabri Novosellës, 31 korrik 1981)

Në fillim të gushtit, Bardhoshi dhe Haxhi Berisha ma gjetën një punë në një fabrikë që në atë kohë më duket se quhej SWF dhe ishte afër stacionit të trenit në Bietigheim-Bissingen, ndërsa banoja në Ludvigsburg. Me Bardhin takohesha më shumë edhe gjatë të javës, kur ai ndalonte shpesh tek ne në konvikt në periferi të Ludvigsburgut, para se ta mbaronte punën e të kthehej në shtëpi, ndërsa me Jusufin takoheshim vikendeve. Ose vinte ai me Bardhoshin tek ne dhe së bashku vizitonim ndonjë mes punëtorësh e ndodhte shpesh Bardhoshi pas mbarimit të punës të premteve na merrte me vete në Untergruppenbach ku qëndronim deri të dielen pasdite.

Në këtë periudhë, Jusufi kishte përgatitur për shtyp numrin 4-5 të revistës. Po nga Jusufi ishte organizuar dërgimi i saj në Kosovë. Për këtë më patë treguar më vonë Haxhi Berisha sepse unë nuk isha kureshtar të dija për gjëra që nuk më nevojiteshin mua. Po në këtë kohë në Shtutgart erdhi edhe libri i Enver Hoxhës "Kur lindi Partia" i cili i dha një impuls diskutimeve rreth bashkimit, apo në thelb mund të thuhen u dha një jehonë zhurmës rreth bashkimit, sepse siç u tregua më vonë mendime serioze për çështjen e bashkimit nga pozita të barabarta prej anës së OMLK-së nuk kishte pasur kurrë. Pas kryerjes së punës teorike e praktike me revistën Liria, Jusufi kishte marrë porosi nga Sabri Novosella qysh më heret, që të filloj me përgatitjen e revistës Zëri i Kosovës, si organ i LNÇKVSHJ. Deri në mesin e gushtit shumica e materialeve për numrin e parë ishin të gatshme. Në këtë kohë ia pata treguar Jusufit disa rrethana për Tahir dhe Nebih Mehën, Emin Latin dhe Azem Bejtën, të cilat i dija nga Kosova. Këto rrethana ia parashtrova atij, duke i treguar edhe një fotografi nga libri i Ajet Haxhiut për Shotën dhe Azemin, në të cilën ishte edhe Emin Lati (Latifi). Nga këto të dhëna Jusufi e shkroi artikullin "Turpi i mizorit dhe lavdia e heronjve". Prej anës time, në jetën time nuk më kishte rënë me e testue veten në shkrime më heret, me përjashtim të hartimeve të lëndës: gjuhës shqipe, në shkollën fillore dhe të mesme, hartime të cilat arsimtarët e mi i çmonin deri në atë shkallë, sa të shumtën e herave më thonin t'ia lexoj klasës, apo i lexonin edhe ata vetë me zë dhe i merrnin si bazë për diskutim.

Për numrin e parë i shkrova artikujt "Do të na bashkoj lufta shoku S." dhe "Imbecili dhe mendimi politik". Unë i bëra vetëm shkrimet, pa ua caktuar titullin. Jusufit i pëlqyen shumë, sidomos artikulli "Do të na bashkoj lufta shoku S." të cilin ai nuk e ndryshoi pothuaja në asnjë fjalë, ndërsa të dytit ia bëri disa riformulime dhe e ndryshoi rreth 10 për qind. Pasi i pëlqyen shumë, unë ia prita se nuk u kam caktuar ndonjë titull, e ai ma hoqi merakun në këtë pikë duke më thënë: – Sa për atë punë, këqyrëm mua!

Edhe Bardhoshi kishte bërë gati disa shkrime të tija, për të cilat kam shkruar në librin "Lëvizja e Jusuf Gërvallës". Përveç kësaj edhe Kadri Zeka ia kishte dhënë Jusufit një artikull të Hydajet Hysenit.

Në librin tim "Protesta e Aspirata" të botuar më 2006, me punimet e mia të zgjedhura, artikullin "Do të na bashkoj lufta shoku S." e kam botuar ndërsa tjetrin "Imbecili dhe mendimi politik" (që ka të bëjë me Mahmut Bakallin) nuk e kam botuar për shkak se në atë kohë (tetor 2006) nuk kam mundur me i dhënë vetes të drejtën ta botoj. Artikulli mendoj se ka qenë i drejtë për vitin 1981, por shkaku se Mahmuti vdiq në prill 2006, dhe në jetën e tij kishte qëndruar në Kosovë, ndikoi në mosribotimin e tij prej anës time.

Atmosferën që ishte rreth Jusufit dhe punëve të Lëvizjes në kohë e ilustrojnë pos tjerash edhe këto fjalë:

Jusuf Gërvalla*: "Materialet e numrit të ardhshëm të "Z.K." janë pothuaj të gjitha të gatshme. Për pjesën e tyre më të madhe, unë,* ***Shpendi*** *(Xhafer Durmishi-shën. im)* ***e Besniku*** *(Bardhosh Gërvalla –shën. i Xh. D.) jemi të kënaqur. Morëm zemër edhe nga fakti se ju kishin pëlqyer edhe juve ato punime që ua dërguam edhe juve për t'i shikuar. Përveç kësaj, unë personalisht tani jam në pozitë shumë më të lehtë, për shkak*

të mendimeve, porosive e sugjerimeve nga ana juaj dhe për shkak të një ndihme, sado të vogël në fillim, nga ana e ***Shpendit****, e Besnikut dhe e* ***shokut të "Lirisë", që këta më dhanë me disa artikuj të mirë****. Edhe* ***Shpendi*** *edhe* ***Besniku****, për sa duket kanë afinitet për shkrim, i cili do të rritet bashkë me punën tonë e me ne. Tani pas hartimit të dy artikujve që kanë mbetur pa u kryer, menjëherë po i hyjmë shtypjes së revistës.* (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451)

9. FORMIMI I KOMITETIT TË DEGËS

Në bazë të porosive të Sabri Novosellës, pas arritjes sime në Shtutgart, u vendos formimi i Komitetit të Degës së Lëvizjes për Gjermani. Në Turqi Sabriu e kishte formuar Komitetin e Degës së Lëvizjes "Hasan Prishtina", dhe ai mendonte se një Komitet analog duhet të organizohet edhe në Gjermani. Nga vështrimi në shikim të parë fitohet përshtypja se pasi në Turqi ka ekzistuar Komiteti i Degës më heret se sa në Gjermani, rrjedhimisht atje është punë më i madhe se sa në Gjermani, sepse ku ka Komitet ka punë dhe ku s'ka Komitet s'ka punë. Por e vërteta nuk qëndron kështu, sepse këto gjëra janë shumë komplekse. Çështja e udhëheqjes së një organizate apo i një rrethi, veprimtaria luftarake është çështje arti, dhe punët e tilla më së miri i kuptojnë dhe drejtojnë artistët. Në këtë kuptim Jusufi ishte një artist i vërtetë.

Megjithatë, në luftën e organizuar, përveç gjendjes faktike, gjendjes reale apo përmbajtjes, kanë rëndësi edhe anët tjera që kanë të bëjnë me rregullat organizative, apo me format organizative. Në Shtutgart, në gusht 1981 aktiviteti praktik apo real ka qenë jashtëzakonisht më i madh se sa që ka mundur të formulohet apo formalizohet në emrin e Lëvizjes. Por principialiteti i Jusufit të cilin ai e demonstron kur është në pyetje Lajmëtari i lirisë tregon qartë se sa rëndësi u kushton ai edhe aspekteve formale apo principeve organizative. Për këtë arsye, në fillim të gushtit, Jusufi, Bardhoshi dhe unë udhëtuam me kerrin e Bardhoshit, një citroen i kuq, në një vend të bukur natyror, në mes Untergruppenbachut dhe Ludvigsburgut, dhe e formuam Komitetin e Degës së Lëvizjes Nacionalçlirimtare, për Gjermani. Por këtë punë, për shkaqe të ditura nuk e shpallëm e as nuk i treguam ndokujt në rreth. Jusufi e kuptonte më së miri rëndësinë e punës në heshtje e pa zhurmë. Rreth tij kishte aktivist shumë të dalluar besnik dhe të ndershëm që mua kurrë nuk më ka rënë rasti të takoj njerëz të tillë në ndonjë tjetër mes. Diskutimi i hapur i ekzistimit të Komitetit do të nxiste diskutime: Kush mund të jetë aty? Dhe pyetja dhe pozita më delikate për Jusufin do të ishte: Pse nuk jam unë aty?! Secili nga aktivistët që kishte kontakt të drejtpërdrejt me Jusufin e ndiente veten si shokun më të afërt të Jusufit, e shihte si relacion të çmueshëm dhe do të do të bënin çmos për të mos e turbulluar. Jusufi ishte tepër i vetëdijshëm për këtë, por prapë se prapë për te ishte me rëndësi ndërtimi i organizatës, krijimi e respektimi i rregullave, hedhja e germave në letër, rregullimi i kontratës me shkrim, e cila që do të qëndronte mbi çdo person, që do të vlente për të gjithë, që do të garantonte vazhdimësi.

Në këtë pikë dhe në të gjitha pikëpamjet pajtohesha me Jusufin. Edhe për mua në ato çaste relacionet faktike kishin rëndësi të dorës së parë para atyre formale. Është e vërtetë se Sabriu më ka vu në kontakt me Jusufin, dhe prezantimi fillestar mund të ketë pasur njëfarë ndikimi tek Jusufi, por ai ndikim ka mundur të jetoj vetëm deri në kontaktin e parë me te dhe jo më shumë. Disa gënjeshtar të mjerë më kanë cilësuar si i preferuari i Sabri Novosellës pranë rrethit të Jusufit në Shtutgart. Në janar të vitit 1981, në shtëpinë e Tefik Strajës në Stamboll e kam takuar Sabriun vetëm tri ditë, ndërsa pranë Jusufit më ka rëndë fati të jem, apo të njihem personalisht e të kem kontakt gjashtë muaj. Unë kurrë nuk jam munduar që para Jusufit ta ndërtoj ndonjëfarë autoriteti duke marrë kredi nga

Sabri Novosella. Një taktikë e tillë do të dështonte menjëherë para Jusufit. Për këtë arsye, nëqoftëse edhe pas javëve të para të arritjes sime në Shtutgart, Sabri Novosella i ka rekomandimet më të mira për mua, shkaku nuk qëndron në ndonjë lloj kryeneçësie pozitive të Sabriut ndaj meje, por vetëm në bazë të asaj çka e njoftojnë Jusufi e Bardhoshi përmes letrave e telefonit, për mua, të cilët kanë rast të më njohin shumë më gjatë se sa që ka pasur rastin të më njeh Sabriu.

Jusufi iu ka kushtuar shumë rëndësi formave organizative, por këto forma nuk kanë qenë kurrë perde, vija apo mure prapa të cilave është krijuar ndonjë distancë me asnjë pjesë të rrethit e tij. Ata që e kanë merituar miqësinë e afërsinë e tij nuk kanë pasur nevojë dhe faktikisht nuk janë mërzitur kurrë për këtë. Afërsia me te në cilësinë e anëtarit të një komiteti apo të një forumi ka pasur rëndësi por kjo nuk ka qenë kurrfarë garancioni, në rast se një cilësi e afërsi e tillë nuk është merituar me të vërtetë, realisht dhe jo vetëm formalisht. Këtu dua të shtojë se prej të gjithë shokëve të atij rrethi në Shtutgart, që kanë qenë afër Jusufit e Bardhoshit, unë jam ai që jam njohur me ta më së voni, jam ai që me ta më ka rënë të rri më së paku.

Se si ka qenë atmosfera e asaj kohe, rrezatojnë më së miri fjalët e Jusufit nga letra e 20 gushtit 1981, dërguar Sabri Novosellës.

Jusuf Gërvalla: *"Mbrëmë ishim me Besnikun (Bardhosh Gërvalla-shën im) te ai personi në Visloh, që na i patë dhënë 3 mijë markat. Sa më shumë që po njihemi me të, aq më i matur, i pjekur dhe i mirë po na duket ai neve dhe me gjasë, edhe ai po fiton gjithnjë simpati më të mëdha për punën tonë.* ***Unë, Shpendi (Xhafer Durmishi-shën im) e Besniku****, duke analizuar anët e mira dhe virtytet e këtij njeriu, kemi vendosur se do të kish qenë mirë ta bënim menjëherë anëtarë të* ***Komitetit të degës së këtushme****."* (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981, Marrë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

Çka tregon letra e mësipërme? Kjo letër është **vërtetimi i parë** se më 20 gusht 1981 (brenda një muaji pas arritjes sime) në Shtutgart ka ekzistue ***"Komiteti i degës së këtushme"*** , do me thënë jo Komitet Qendror. Anëtarë të këtij *"Komiteti të degës së këtushme"* janë **Jusuf Gërvalla, Xhafer Durmishi (Shpendi) dhe Bardhosh Gërvalla (Besniku)** të cilët i analizojnë anët dhe virtytet e mira të një bashkatdhetari në Visloh (Isa Bulan-shën i Xh. D.) afër Heidelbergut dhe vendosin se do të kish qenë mirë ta bënim atë menjëherë anëtarin e katërt të "***Komitetit të degës së këtushme****."*

10. Na nevojitet mendimi juaj i prerë

Jusuf Gërvalla: ***"Unë, Shpendi (Xhafer Durmishi-shën im) e Besniku (Bardhosh Gërvalla-shën im)****, duke analizuar anët e mira dhe virtytet e këtij njeriu, kemi vendosur se do të kish qenë mirë ta bënim menjëherë anëtarë të Komitetit të degës së këtushme. Na nevojitet* ***mendimi juaj i prerë*** *për të* ***se ju keni*** *ku e merrni këtë* ***mendim****." (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981.* E Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari në librin Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

Personi që Jusufi e takon është Isa Bulan, që ka banuar në Karl-Theodorstr. 4 D-6908 Wiesloch. Familja e Isës me sa më kujtohet ka qenë nga Mitrovica e shpërngulur në Prizren dhe një pjesë e familjes e ka pasur mbiemrin Prekadini. Në Turqi ka jetua Abdullah Prekadini, i cili prej vitesh ka kontakte spontane e për festa me konsullatën shqiptare në Stamboll. Jusufi kërkon mendim të prerë nga Sabri Novosella para se ta afroj më shumë Isën, para se t'i propozoj ta bëjë anëtarë të Komitetit të degës së Gjermanisë. Me fjalët *'ju keni ku e merrni këtë mendim'* Jusufi ka parasysh Bujar Hoxhën. Baza e këtij besimi nuk është vetëm tek principet e Jusufit por edhe tek fakti se Sabriu lavdohet e krenohet deri në kulm për atë se sa i shkëlqyeshëm është raporti i tij me Bujar Hoxhën.

11. ASPEKTE EKONOMIKE RRETH LUFTËS DHE LËVIZJES SË JUSUF GËRVALLËS

-1. Unë isha pa pasaportë me pak të holla në xhep
-2. Se ke për gjë të kërkosh të holla te emigracioni
-3. Unë i jam përmbajtur marrëveshjes, ata jo
-4. Shabani është një milioner
-5. Arriti shuma e të hollave që kërkoheshin prej tij
-6. Kërkonte një njeri "të ndershëm e trim"
-7. Mendime të urta dhe të njerëzishme
-8. Ai personi që na i patë dhënë 3 mijë markat
-9. Jusufit i vijnë 10 mijë dollarë amerikan nga Turqia
-10.E BIJA E JUSUF GËRVALLËS, DONIKA DEMANTON
-11. NË RRUGËN NËPËR TË CILËN MË KANË ARRITUR KËTU PARATË E MBLEDHURA PËR MAKINË
-12. Korrektësia e tij shfaqej në çdo gjë

-1. Unë isha pa pasaportë me pak të holla të xhep

Jusuf Gërvalla: *"Unë isha pa pasaportë me pak të holla në xhep. Qëllimi ish që nga Jesenica të kontaktoja me Bardhin, që të vinte e të më merrte me vete. Por bllokun me numra telefonash e me adresa ia kisha lënë Suzanës, që ta bënte Bardhin me dije që të mos vinte në Jugosllavi, se ishte rrezik edhe për te, e kur pata dalë shtëpie s'më kishte shkuar mendja që do të ikja për në Gjermani (mendoja se do të ketë mundësi për Shqipëri)."* (Ditari, 30 dhjetor 1979; Jusuf Gërvalla, Vepra, Prishtinë 2010, Vëllimi 4, faqe 246)

-2. Se ke për gjë të kërkosh të holla te emigracioni

Jusuf Gërvalla: *"Dhe kjo, sipas mendjes sime, është e keqja. Sepse, siç ta kam thënë edhe më parë (e ti s'ia ke vënë veshin), edhe këtu konspiracioni duhet të jetë i plotë, dhe sidomos këtu. E dyta, ti se ke për gjë të kërkosh ndihma në të holla (dhe në armë!) te emigracioni, i cili ka një cak të kundërt me atë të punës sate, e pastaj të biesh në rezignacion aq të panevojshëm, kur po ky emigracion u bie kambanave të shpifjeve, të cilave ua ka anën. Kur është një gabim shumë i madh dhe kur unë ta them se është gabim e t'i marr shembull pasojat që ke pasur, ti ma zë për të madhe pse unë po ti mbaj te hunda disa cikërrime që t'u kanë përvjedhur pahiri. Vërejtjet e mia ti i merr si atak rivaliteti mbi personalitetin tënd, që do të thotë se nuk je i gatshëm për të nxjerrë mësime nga pësimet dhe për autokritikë (sa do që rolin e autokritikës nuk e mohon. [J.G]"* (Letër Ibrahim Kelmendit, nëntor 1980; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 282-283)

-3. Unë i jam përmbajtur marrëveshjes, ata jo

Me letrën e mëposhtme Jusufi vërteton se ai ka pasur një marrëveshje, të bërë në dhjetor 1980, me Ibrahim Kelmendin dhe Hysen Gegajn, në bazë të së cilës Jusufi me anë të shkrimeve ta mundësoj daljen e gazetës Bashkimi, ndërsa të hollat për shtypjen Lajmëtarit të lirisë, të sigurojnë Hyseni e Ibrahimi. Burgosja e Hysenit i prishë të gjitha planet në këtë drejtim.

Jusuf Gërvalla: *"Mendoj unë se duhesh t'i marrësh me vete nja 400 DM nga ato të fondit të krijuar deri më tash. Me I. (Ibrahim Kelmendin-shën i Xh. D.) dhe H. (Hysen Gegajn-shën i Xh. D.) kemi pasur një marrëveshje konkrete, që unë të shkruaj për "Bashkimin", t'i përpunoj materialet e shkruara prej të tjerësh dhe ta shtyp gjithë materialin në makinën time të shkrimit. Unë i jam përmbajtur marrëveshjes, ata jo. Deri më tash, ata më kanë dhënë vetëm 200 DM për shtypjen në shtypshkronjë të "Lajmëtarit të Lirisë", kurse marrëveshja ka qenë që të hollat për shtyp t'i sigurojnë ata, meqë unë nuk jam në gjendje të paguaj nga xhepi im. (Deri më tash, dy numrat e revistës i kam paguar me të hollat e mia, sikurse edhe makinën e shtypit, gjithsejtë mbi 9.000 DM, kurse kontribute nga shokët kam marrë gjithsejtë 1.300 DM.) Për këtë arsye, numri i parë (për këtë vit) më ka ndenjur qe më se dy javë i gatshëm, sepse nuk kisha të holla ta dërgoja në shtyp."* (Letër Nuhi Sylejmanit, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 30-32)

-4. Shabani është një milioner

Jusuf Gërvalla: "*Më ke pyetur si qëndrojmë me çështjen financiare, lidhur me nxjerrjen e gazetës. Numri i parë, i cili është radhitur e shtypur krejtësisht në një shtypshkronjë, e që është e natyrshme që ka dalë teknikisht më së miri, ka kushtuar 2540 mark. Ky ishte një çmim shumë i lartë sa të mund ta përballoja, madje edhe me pjesëmarrjen modeste të disa njerëzve që u treguan të gatshëm të ndihmojnë (pa e ditur për çka është fjala). Prandaj, bashkë me vëllaun vendosëm ta marrim me kredi një makinë shkrimi të përshtatshme (është kjo, me të cilën po ta shkruaj letrën dhe me të cilën janë radhitur dy numrat e fundit të "Lajmëtarit të lirisë"). Makina kushtonte relativisht pak (5080 mark) dhe, me disa funksione elektronike që kryente, jepte mundësi të nxirrej disi revista, sado që mua më ngarkonte shumë, sepse, pos që i shkruaja të gjithë artikujt, më duhej edhe t'i radhitja e t'i përgatisja teknikisht të gjitha faqet. Por, shpenzimet që mbeteshin për t'iu paguar shtypshkronjës në proçesin e mëtejshëm të shtypjes e të shumëzimit të revistës, ishin shumë të vogla, vetëm 600 mark.*

Por kur është fjala për botimin e "Zërit të Kosovës", mendoj se del edhe një problem. Sipas të gjitha gjasëve, tashmë është identifikuar se kush qëndron prapa "Lajmëtarit" dhe kështu edhe mënyra se si radhitet ai. Pra, kjo makinë shkrimi, sipas mendjes sime, nuk do të duhej të përdorej edhe në radhitjen e "Zërit të Kosovës". Kurse radhitja në shtypshkronjë kushton shtrenjtë, siç u pa. Mbesin dy mundësi: ose të shitet kjo makinë (po tash me çmim më të ulët, se kështu ngjan këtu) dhe të blehet një lloj tjetër makine, duke shtuar edhe para të tjera, ose të merret kohë pas kohe me qira ndonjë makinë tjetër për radhitjen e gazetës. Se sa do të shpenzoheshin me variantin e parë dhe sa me të dytin, të informoj këto ditë në telefon, por e di se, për një punë më të rregullt në nxjerrjen e gazetës, do të duhej një ndihmë bukur e madhe financiare. Dhe unë nuk e di se sa keni mundësi, Ti me shokët, të ndihmoni së andejmi. Për shembull, një makinë për radhitje, me të gjitha llojet e germave ë përdoren në gazeta e libra e që prandaj s'ka si të identifikohet, e re kushton mbi 20 mijë mark, po e përdorur ka mundësi të gjendet edhe 10 mijë. E këto janë para të mëdha. Ndryshe, po të zgjidhet çështja e makinës, shpenzimet e shumëzimit të revistës do t'i përballoja vetë, me disa shokë këtu, pa kurrfarë problemi. Këtu kam një propozim. Ai shoku në Mynhen, përmes të cilit e mora lidhjen me Ty, Shabani, është një milioner. Nëse shokët që ke Ti atje kanë ndikim në të, atëherë ai do të mund të na ndihmonte në blerjen e një makine të tillë, bile nuk do ndiente shpenzimet. Por, kjo është çështje që duhet ta vendosni ju." (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 198; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 264-265)

-5. Arriti shuma e të hollave që kërkoheshin prej tij

Jusuf Gërvalla: "*Me shokun Sh. (Shaban Yldrim-shën i Xh. D.) në Mynih nuk kemi biseduar gojarisht, po vetëm në telefon. Ai tha se do të më përgjigjet brenda një kohe të shkurtër, por ende nuk është përgjigjur. Ndërkaq te shoku I. në Visloh ishim. Na priti mirë. Por kohën e bisedës e kishim të kufizuar, se i erdhën mysafirë të tjerë. Paske marrë vesh për një bisedë të nxehtë, që u zhvillua në banesën e tij me atë rast me disa kopukë projugosllavë. E di që nuk kam bërë aq mirë që kam folur, por, unë e pata paralajmëruar* ***shokun I.*** *të mos më ndalte, sepse nuk mund të durohen kur fliten muhalife.. Pos kësaj, ja lëshova frenin vetes pak më shlirshëm, duke ditur se shoku I. nuk është aspak i varur nga Jugosllavia. Përveç kësaj, unë mendoj se kjo gjë duhet të ketë pasur një efekt të mirë te* ***shoku I.*** *(Isa Bulan,* Karl-Theodorstr. 4 D-6908 Wiesloch - shën. i Xh. D.) *Ai e pati rastin të njihet me disa pikëpamje dhe me shkallën time të informimit; lidhur me realitetin kosovar. Po të bëj me dije se këto ditë arriti prej tij edhe shuma e të hollave që kërkoheshin prej tij."* (Letër Sabri Novosellës, 16 qershor 198; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010 faqe 270)

-6. Kërkonte një njeri "të ndershëm e trim"

Jusuf Gërvalla: "*Nga dita e arratisjes sime në RF të Gjermanisë, më 14 dhjetor 1979, këtu kam pasur kontakte me përfaqësues të Grupit komunist "Zëri i Kosovës" dhe pastaj me ata të organizatës Fronti i Kuq Popullor. Le të më lejohet të shënoj këtu disa përshtypje dhe disa vrojtime lidhur me punën e tyre,* ***aq më parë lidhur me punën e Frontit të Kuq, pasi Dega "Hasan Prishtina" mendon se është e arsyeshme të thërriten edhe përfaqësuesit e tij për bashkimin e organizatave dhe të veprimtarisë sonë****."* (Raport për LNÇKVSHJ, korrik 1981)

Faridin Tafallari: "Më kujtohet një takim ku kam qenë edhe unë i pranishëm. Jusufi e pyeti Ibrahimin që t'i tregonte se sa të holla kishte marrë nga një organizatë kroate (emrin e saj nuk e di). Sipas fjalëve të Ibrahimit ka qenë puna për një shumë prej ***50 mijë markash gjermane****, që do të përdoreshin për të blerë armë. Këtë shumë e kanë marrë njerëzit e Ibrahimit, mandej si i përdori ato për të rregulluar një lokal kafeneje në Pejë. Jusufit kjo gjë nuk i pëlqeu dhe e kundërshtoi veprimin e Ibrahimit si jo të mirë. Ibrahimi përgjigjej se kur gjen budallenj pse të mos përfitosh. Jusufi ia ktheu: "Ato para janë marrë për diçka tjetër dhe për një çështje tjetër, dhe janë përdorur për interesat tua. Për tjetër janë kërkuar dhe për tjetër janë shfrytëzuar."* (Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f. 57)

Jusuf Gërvalla: *"Pikërisht në kohën që jam njohur unë me të, ai ka pasur kontakte, madje edhe negociata me emigracionin reaksionar shqiptar për një veprimtari të përbashkët në mbledhje armësh dhe mjetesh materiale. Madje në atë kohë, Ibrahimi kërkonte një njeri "të ndershëm e trim", që për një kundërshpërblim prej nja 50 mijë markash gjermane, do të kryente në Kosovë një aksion sipas porosisë së reaksionit shqiptar antikomunist. (Lidhur me këto çështje kemi pasur një dialog të përbashkët dhe bukur të rreptë në praninë e tij unë dhe dy shokë nga Vjena, lidhur me këtë është dashur të jetë i informuar patjetër Profesori, në qoftë se është i informuar për çkado lidhur me I. Kelmendin.)* (Raporti, korrik 1981)

Shtrohet pyetja se prej nga i vjen e drejta Jusufit që t'i komentoj çështjet ekonomike të Ibrahim Kelmendit?

Ibrahim Kelmendi në kohën sa ka dalur gazeta Bashkimi, është prezantuar si figura kryesore e Frontit të Kuq. Për ata që thonë se ai ka vepruar në bazë të rregullave të

ilegalitetit dhe nuk e ka reklamuar veten para të tjerëve si figura frontale e Frontit të Kuq, mund të them se edhe mund të kenë të drejt, por fatkeqësisht, në këtë mes, është Tanjugu ai që nuk ka respektuar kurrfarë rregulli, dhe nuk ka lëshuar rast pa e reklamuar Ibrahim Kelmendin. Reklama e Tanjugut për Ibrahimin, si armik të Jugosllavisë, u ka bërë përshtypje emigracionit të vjetër e sidomos atij kroat. Si dokumente për me e vërtetua armiqësinë e tij ndaj Jugosllavisë, Ibrahimi parelive të ndryshëm ua tregon gazetën Bashkimi, botimin e së cilës, me përjashtim të numrit të parë, e ka mundësuar Jusufi. Në këtë kuptim mund të thuhet se Jusufi ka të drejt të ketë mendime në këtë pikë dhe të deklarohet për to, ashtu siç ka vepruar. Përveç rastit të Hysen Gegës, mund të themi se edhe dimensioni i mercenarizmit rreth Frontit të Kuq është faktor që ndikon tek Jusufi, që ai prej fundit të dhjetorit të vitit 1980 t'i ndërprenë të gjitha marrëdhëniet me Ibrahim Kelmendin.

Këtu duhet ta nënvizojmë faktin se Jusufi i komenton por nuk përzihet në punët e brendshme të Frontit të Kuq dhe as që ka qëllimin për t'i kërkuar llogari Ibrahim Kelmendit. Pse? Sepse llogari mund t'u kërkosh vetëm personave me të cilët je së bashku në një organizatë, e Jusufi kurrë në jetën e tij nuk ka qenë anëtarë i një organizate së bashku me Ibrahim Kelmendin. Por megjithatë Jusufi nuk është pasiv dhe në mënyrë të përpiktë e bën atë që është në dorën e tij. I ndërprenë të gjitha marrëdhëniet me Ibrahim Kelmendin e Frontin e Kuq dhe angazhimin e tij në gazetën Bashkimi.

Çështja e komenteve të Jusufit justifikohet edhe më tepër kur të kihet parasysh fakti se Sabri Novosella kërkon prej tij që të bisedoj me Ibrahim Kelmendin për bashkimin e Lëvizjes me Frontin e Kuq. Jusufi në këtë rast obligohet, detyrohet patjetër ta jep shpjegimin e vet, pse ai për të gjallë të tij nuk mund të lejoj që Lëvizja e tij të bëjë bisedime rreth bashkimit me Frontin e Kuq, të bashkëthemeluar dhe të emërtuar nga UDB-a.

-7. Mendime të urta dhe të njerëzishme

Jusuf Gërvalla: *"Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit)."* (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 451)

-8. Ai personi që na i patë dhënë 3 mijë markat

Jusuf Gërvalla: "*Sa i përket maqinës për shtypjen e „Z.K.", të njoftoj se shoku I. B. (Isa Bulan,* Karl-Theodorstr. 4 D-6908 Wiesloch - shën. i Xh. D.) *e ka kryer atë që lypsej prej tij. Shoku Sh. (*Shaban Yldrim, Bayerstr. 5, 8000 München - shën. i Xh. D.) *Është përgjigjur pozitivisht, por ende s'e ka kryer punën. Ai thotë se pak më vonë do të na përgjigjet me një shumë 4-5 herë më të madhe.*" (Letër Sabri Novosellës, 21 korrik 1981)

Jusuf Gërvalla: *"Mbrëmë ishim me Besnikun te ai personi në Visloh, që na i patë dhënë 3 mijë markat. Sa më shumë që po njihemi me të, aq më i matur, i pjekur dhe i mirë po na duket ai neve dhe me gjasë, edhe ai po fiton gjithnjë simpati më të mëdha për punën tonë. Unë, Shpendi e Besniku, duke analizuar anët e mira dhe virtytet e këtij njeriu, kemi*

vendosur se do të kish qenë mirë ta bënim menjëherë anëtarë të Komitetit të degës së këtushme. Ne nevojitet mendimi juaj i prerë për të se ju keni ku e merrni këtë mendim." (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452)

-9. Jusufit i vijnë 10 mijë dollarë amerikan nga Turqia

Xhafer Durmishi: "Në mesin e shtatorit Jusufit i bien në dorë diçka e mirë. Ai e blen një maqinë për përgatitjen e "Zërit të Kosovës, të markës IBM, e quajtur me emrin e plotë "IBM Electronic Selectric Composer". Në vitin 1975 IMB-i lajmëron, reklamon maqinën "IBM Electronic Selectric Composer." Ky Composer ka mundësi të mbaj mend (në kapacitetin e memories) rreth 5000 goditje (shtypje të tangjenteve të maqinës), rreth 2 faqe A4. Kjo maqinë ka qenë një përmirësim dramatik i maqinës origjinale të quajtur "IBM Composer".

Faridin Tafallari dhe Nuhi Sylejmani ia huazojnë Jusufit së bashku rreth 6000 (gjashtëmijë) apo diçka më shumë, marka gjermane (DM) dhe me këto të holla paguhet makina (duke ia shtua një pjesë më të vogël edhe Bardhi e Jusufi). Çmimi, me të cilën kjo makinë është ble ka qenë rreth 8000. Dy muaj më vonë (nëntor 1981), Jusufit i vijnë 10 mijë dollarë amerikan nga Turqia. Sipas kursit të dollarit me markën gjermane në vitin 1981, 10 mijë dollarë kanë bërë 22 mijë e 600 marka. Prej këtyre të hollave Jusufi ua kthen huan Faridin Tafallarit e Nuhi Sylejmanit.

Këtë shumë të hollash Jusufi nuk e ka komentua me mua. Suzana më ka thënë se këto të holla, Jusufit dhe Lëvizjes së tij i kanë ardhë përmes Sabri Novosellës nga Turqia, dhe donatori është Aziz Vojnovci. Më vonë, në vitin 1984 Sabri Novosella, edhe pse nuk më ka thënë në mënyrë direkte ka aluduar se ato të holla ia ka dhënë Bujar Hoxha."

-10.E BIJA E JUSUF GËRVALLËS, DONIKA DEMANTON

Xhafer Leci: "*Në Ludwigsbug të Gjermanisë më 20.01.2013, në kuadër të Klubit Kulturor „Bardhosh Gërvalla“ u organizua Akademi Përkujtimore për 31 vjetorin e vrasjes mizore të Tre Pishtarëve të lirisë, nga UDB-a jugosllave....*

E bija e Jusuf Gërvallës, Donika*, veç tjerash, foli për xhaxhain e saj, Bardhoshin, të cilin e vlerësoi lart për punën e tij të vyeshme për mbajtjen e familjes, për aktivitetin politik, si botimin e fletushkave "Zëri i Kosovës" dhe "Lajmëtari i Lirisë", duke i financuar vet.* ***Ky fakt, demanton bindshëm kundërshtarët e djeshëm dhe të sotëm të v!llezërve Gërvalla, se kinse ka financuar dikush tjetër, bile nga larg****. Donika shtoi se, duke folur më shumë për dy heronjtë e tjerë, Bardhoshi, pa të drejtë, është lënë si në harresë."* (Akademi dinjitoze për tre heronjtë Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka, www.botasot.info, 31 janar 2013)

Partia Komuniste (PKMLSHJ)**:** *"Menjëherë pas kësaj demonstrate (sipas N.S. të 4 korrikut 1981 në Frankfurt-shën i Xhafer Durmishit), ne nëntë anëtarët e celulës „Vullneti“ u mblodhëm për të diskutuar rreth mundësisë së grumbullimit të parave për blerjen e makinës së shkrimit, për të cilën ditë më parë kishim diskutuar me Jusufin. Pasi i pleqëruam hollësisht mundësitë tona, arritëm në përfundim se vetëm ne, nëntë anëtarët e celulës sonë, që ishim: Nuhi Sylejmani, Ismet Klaiqi, Shaban Klaiqi, Mejdi Rexha, Islam Rafuna, Ismajl Qirezi, Hesat Dushica, Abdurrahman Sadiku dhe Rasim Lipovica, pa u zgjeruar me shokë të tjerë, kishim mundësi që ta grumbullonim shumën e nevojshme. Vendosëm t'i ndajmë nga 2.000 marka për çdo anëtar. Brenda një kohe të shkurtër u grumbulluan 18.000 marka. Me pëlqimin e shokëve, i mora paratë dhe shkova në shtëpinë e vëllezërve Gërvalla. Të dy vëllezërit i gjeta në shtëpi. Më pritën jashtëzakonisht ngrohtë.*

Pas bisedave të rëndomta, i tregova Jusufit arsyen e vizitës, duke ia lëshuar në dorë shumën prej 18.000 markash. Fytyra i ndriti nga kënaqësia e beftë. Shumën në fjalë ia dorëzoi Bardhoshit, duke më falënderuar përzemërsisht.

*(Këto të dhëna që dëshmohen nga nëntë anëtarët e celulës „Vullneti“, janë në kundërshtim të plotë me ato që shkruan Fahredin Tafallari, në faqen 35, të librit të tij me titull „Terror, dhembje, qëndresë“, se gjoja ai ia paskësh huazuar Jusuf Gërvallës 3.000 marka për blerjen e makinës së shkrimit.) Në ditët pasuese Bardhoshi e kishte blerë një makinë shkrimi të tipit **„Olivetti**“, në vlerë **prej 13.000 markash**. Edhe pse makina nuk ishte e re, i plotësonte të gjitha standardet e nevojshme. Ndërsa, me mbetjen prej 5.000 markash kishte blerë dy videorekorderë të rinj, me qëllim inçizimi dhe shumëzimi të materialeve propagandistike dhe filmave nga kinostudioja „Shqipëria e Re“.* (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, 2010, faqe 56)

-11. NË RRUGËN NËPËR TË CILËN MË KANË ARRITUR KËTU PARATË E MBLEDHURA PËR MAKINË

Jusuf Gërvalla: "*Mendoj se në revistën tonë duhet të bëjë vend sa më shpejt një artikull mbi marrëdhëniet shqiptaro-serbe në periudha të ndryshme. Qëllimi është që të shihet kontinuiteti i aspiratave pushtuese, kolonizuese serbe dhe shovinizmi i tyre, që shkon deri në dëshirën për shfarosjen e plotë të popullit shqiptar. Si literaturë bazë mund të shërbejnë disa punime të Sadulla Brestovcit në "Gjurmime Albanologjike", librat e Shukri Rahimit "Vilajeti i Kosovës" dhe "Lufta e shqiptarëve për autonomi 1897 – 1912", libri i Z. Canës "Lëvizja kombëtare shqiptare 1908 – 1912", ai i D. Tucoviçit "Serbia dhe Shqipëria", i Kosta Novakoviçit " Politika e Serbisë në pushtimin dhe serbizimin e Kosovës"(për titullin e këtij të fundit nuk jam krejtësisht i sigurt në është i saktë), libri i Shaban Brahës "Idriz Seferi " etj. Tema duhet të shtjellohet nga një historian i rryer, së pari për nevojat e revistës e pastaj, nëse zgjerohet, mund ta nxjerrim edhe si broshurë a libër. Unë do të përpiqem nga ana ime të gjej njeri të tillë, por edhe më shumë të përpiqeni ju andej. Ideale do të kish qenë sikur përmes **Plakut (Bujar Hoxhës-***shën. i Xh. D.), materiale të tilla me peshë të mund të siguroheshin **në rrugën nëpër të cilën më kanë arritur këtu paratë e mbledhura për makinë....***

Pres propozime e sugjerime edhe për tema të tjera, me realizimin e të cilave do të rrekeshim unë, Shpendi e Besniku." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 275-276)

-12. KORREKTËSIA E TIJ SHFAQEJ NË ÇDO GJË

Faridin Tafallari: *"Një ditë Bardhoshi më thirri në telefon në firmën ku punoja dhe më tha: 'Faridin, sonte ty dhe Nuhi Sylejmanin ju ka thirrur Jusufi që të vini se ka diçka me bisedue'. Unë mora Nuhiun dhe shkuam te Bardhoshi në Ludwigsburg. Pritëm deri sa la punën dhe së bashku vajtëm te Jusufi. U gëzua edhe ai kur na pa. Pas shumë bisedimesh na lajmëroi se do të nxirrte një gazetë, "Zërin e Kosovës", të cilin e kishte në përgatitje e sipër. Pas një heshtje të shkurtër na tha: "Pra sonte do t'ju kërkoj ca të holla se kam gjetur një makinë radhitëse shtypi. Kur është e re ajo kushton 20 mijë marka, por unë e kam gjetur një makinë pak të përdorur, po që është e mirë dhe që kushton 9 mijë marka." Unë dhe Nuhiu i thamë që ta blente makinën se ne do ta ndihmonim atë. Dhe ashtu u bë; të hollat ia çuam disa ditë më vonë dhe unë i dhashë 3000 DM. Pas një kohe mua m'i ktheu të hollat, sepse ashtu më kishte thënë. Korrektësia e tij shfaqej në çdo gjë."* (Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f.35)

Këto janë të gjitha aspektet ekonomike të Jusufit gjatë tërë aktivitetit të tij politik. Jusufi nuk i ka kërkuar të holla as Enver Hoxhës e as Shtetit Shqiptar, as në lekë dhe as në ndonjë valutë tjetër, as në ndonjë shumë të caktuar e as të pacaktuar, as me gojë e as me shkrim. Të gjitha shpifjet në këtë drejtim janë shpifje mercenarësh, si tentim për hakmarrje për shkak të demaskimit që ua ka bërë atyre vetë Jusufi. Nëqoftëse Shteti Shqiptar i ka ndihmuar Jusufit përkundër faktit se ai këtë ndihmë, në këtë formë, kurrë nuk e ka kërkuar, atëherë ky është prapë edhe një fakt që tregon se aty ku i kishte drejtuar sytë Shqipëria aty i kishte drejtuar sytë edhe Jugosllavia. Por, për dallim nga Shqipëria, drejt Jusuf Gërvallës, Jugosllavia, përveç syve e kishte drejtuar edhe shënjestrën.

12. TEZAT RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS TË OMLK-së

Në verën e vitit 1981 u botua libri i Enver Hoxhës Kur lindi partia, me rastin e 40 vjetorit të formimit të PKSH. Ky libër u lexua, e qarkulloi në rrethin tonë në Shtutgart në gusht e shtator 1981. Nuk kaloi kohë e gjatë e Jusufit, në mesin e shtatorit i dërgohen, nga Kadri Zeka TEZAT RRETH FRONTIT POPULLOR PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS. Në këtë kohë shumicën e ditëve të javës i kaloja në Ludwigsburg, ku banoja me Haxhi Berishën dhe Naim Haradinajn, ndërsa me Jusufin takoheshim çdo të shtunë-diele. Të shtunën e parë pas ardhjes së Tezave, si kam shkue te Jusufi, në mes nesh biseda filloi në këtë mënyrë:

Jusufi:	- Kam lajme shumë të mira.
Unë (Xh. D):	- Pse çka ka ndodh?
Jusufi:	- Do t'i bëjmë edhe ne si Lech Walesa!
Unë (Xh. D.)	- E qysh si Lech Walesa?
Jusufi:	- Shikoi e lexoj këto Teza që na kanë ardhur!

Teksti i plotë i këtyre Tezave gjendet në librin tim "Lëvizja e Jusuf Gërvallës".

Kadri Zeka ia dërgon Jusufit Tezat për tri qëllime:

-1. Ta njoftoj për ekzistencën e tyre, Teza të cilat OMLK-ja i ka përpiluar në Maj 1981,

-2. Ta dij se si po pritet përmbajtja e këtyre Tezave nga Jusufi dhe rrethi i tij dhe

-3. Ia jep porosinë që t'i shtyp grafikisht, t'u jep një formë estetike me njohurit e tij ashtu siç kishte bërë më parë me tre numrat e fundit (3 dhe 4-5) të revistës Liria.

Jusufi u pajtua me përmbajtjen e tyre, dhe teknikisht i shtypi e radhiti në mënyrë shumë më të mirë se sa që kishte bërë me tre numrat e revistës Liria. Këtë ia mundësonte makina shumë e avancuar e asaj kohe **IBM Electronic Selectric Composer.** Shtypja e këtyre Tezave është puna e parë dhe e fundit që Jusufi e bënë për llogari të OMLK-së me makinën e tij të markës së lartpërmendur IBM. Pas radhitjes, Jusufi i shumëzoj këto teza, i dërgoi një numër ekzemplarësh Kadri Zekës në Zvicër dhe vet i shpërndau në krejt rrethin e Shtutgartit. Bashkimi shikohej si një çështje dite, bisedat dukej se do të ishin vetëm formalitet me një procedurë shumë të shkurtë. Jusufi kurrë nuk do të përshkruante (radhiste) ato teza e t'i shpërndante sikur të mos pajtohej pikë për pikë me pikëpamjet e tyre.

Ibrahim Kelmendi nuk ishte i involvuar në këtë punë sa i përket pjesës së Jusufit, siç e dëshmon RAPORTI i korrikut dhe letra e 20 gushtit, të dyja dërguar Sabri Novosellës.

Jusuf Gërvalla: *"Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".*

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport, korrik 1981)

Jusufi e kishte parasysh se atë punë me siguri do ta bënte Kadri Zeka, aq më parë kur TEZAT kishin ardhur prej tij, dhe ishte detyrë e tij t'a bëjë zbërthimin dhe interpretimin e parë të tyre dhe jo e të tjerëve.

Bisedat e komunikimet e Jusufit dhe Kadri Zekës në këtë çështje mund të përmblidhen kështu:

K. Zeka: Si t'u dukën Tezat?
Jusufi: Shumë të mira, gjërat nuk mund të thuhen më qartë e më mirë.
K. Zeka: Atëherë mund të bashkohemi duke u bazuar në Tezat!
Jusufi: Patjetër, çështjen e bashkimit e shikoj më tepër teknike dhe formale.
K. Zeka: Është mirë të bashkohemi e të formohet Fronti sa më parë!
Jusufi: Është mirë të bashkohemi e të formohet Fronti dhe struktura organizative siç parashtrohet në Teza!
K. Zeka: Atëherë çka presim?!
Jusufi: Atëherë çka presim?!

Tezat, Jusufi i ka kuptuar në këtë formë:
- Formimi i partisë pararojë (Partisë Komuniste) e cila do ta udhëheqë Frontin,
- Në Partinë Komuniste do të hyjnë kuadrot më të formuara dhe më të dëshmuara.

Këtë lloj interpretimi e ka lënë të nënkuptohet Kadri Zeka gjatë kontakteve me Jusufin. Kadri Zeka nuk e ka bërë asnjë koment të vetëm shtesë para Jusufit, se si duhet kuptuar tezat në të vërtetë. Duke u sjellur në rreth, sa i përket kësaj çështje, Jusufi i thotë Kadriut, se unë me Tezat pajtohem por për t'u sqaruar konkretisht është shoku më kompetent i LNÇKVSHJ, Sabri Novosella, që gjendet në Turqi. Ti e ke përkrahjen time, me vete i merr Tezat që ua kam radhitur, dhe përveç kësaj si shok të rrugës që të mos mërzitesh e ta kesh krah po ta jep Bardhin.

13. Pse ke ardhur?

Rreth 12 tetorit 1981 Kadriu dhe Bardhoshi udhëtojnë me aeroplan në Stamboll për çështje të "bashkimit" - bishtëzimit. Dëshmitari i gjallë i këtyre takimeve Sabri Novosella ka shtrembëruar çdo fjalë sa i përket këtij takimi.

Jusufi nuk ka përgatitur asgjë me shkrim për bisedimet e Stambollit të tetorit 1981, as Bardhoshit nuk i ka thënë asnjë fjalë për ndonjëfarë Lëvizje për Republikë apo Kombëtare. Jusufi është pajtuar me germën dhe me frymën e Tezave rreth Frontit për Republikë, ashtu si ai i ka lexuar ato dhe si ua ka përcjellë vetë të tjerëve. Në Stamboll, gjatë bisedimeve Kadriu jep sqarimin e vetë konkret e lakuriq se si duhet lexuar tezat:

- Jo parti pararojë (Jo Parti Komuniste Marksiste-Leniniste) e përbërë nga anëtarë të organizatave të tjera, por vetëm nga radhët e OMLK-së,
- vetëm anëtarët e OMLK-së janë marksistë, komunistë të formuar,
- në organizatat tjera të tillë nuk ka, prandaj të tjerët - në Front për Republikë, nën udhëheqjen e OMLK-së.

Bardhoshi u kthye nga Stambolli me sa më kujtohet të premten në mbrëmje më 16 tetor 1981. Në këtë datë bazohem në faktin se Panairi i librit i Frankfurtit, në vitin

1981 është mbajtur prej 14 (e mërkure) deri më 19 (e hënë) tetor 1981. Me Jusufin dhe shumë shokë të Shtutgartit ishim organizuar të shkonim në Panair. Por, Panairi në ditët e para (e mërkurë, e enjte dhe e premte) është i rezervuar vetëm për konferenca e tubime për ata që kanë ftesa e rezervime për ligjërata të ndryshme, ndërsa të shtunën dhe dielën është i hapur për të gjithë. Kështu, saktësisht në ditën e parë të hapjes së Panairit të librit në Frankfurt, për publikun e gjerë, dhe pikërisht, në kerr, në autostradë, gjatë rrugës për në Frankfurt, Bardhi na e shpjegoi mua e Jusufit rrjedhën e bisedimeve në Stamboll, ndeshjen e cakërrimet frontale rreth Frontit, në mes Kadri Zekës dhe Sabri Novosellës. Jusufi rrjedhën e këtyre bisedime e kishte dëgjuar qysh të premten në mbrëmje, por kishte dëshirë që Bardhi ta përsërit tregimin e tij edhe në praninë time e për mua.

Bardhoshi tregoi se bisedimet në mes Sabri Novosellës e Kadri Zekës sa i përket bashkimit ishin të shkurta, dhe u ndërprenë shumë shpejt pasi Kadri Zeka tha se nuk ka ardhë të bisedoj për bashkim.

Thelbin e bisedimeve ai e tregoi me këto fjalë:

S. Novosella: Mund të fillojmë bisedimet për çka jemi mbledhur, bisedimet për bashkimin e organizatave në një të vetme?

Kadri Zeka: Ne jemi për krijimin e një Fronti në bazë të këtyre tezave, i cili do të udhëhiqet nga OMLK!

S. Novosella: Ne kemi menduar se do të vish për çështjen e bashkimit të organizatave. Është çështja e këtyre bisedimeve për shkak të të cilave ne e kemi pezulluar nxjerrjen e "Zërit të Kosovës" qe disa muaj!

K. Zeka: Unë nuk kam autorizim me bisedua për bashkimin më shumë se ajo që thash, e që është në teza!

S. Novosella: Atëherë pse ke ardhur?

K. Zeka: Që të shihemi!

S. Novosella: Sa për t'u parë, mua më shumë më ka marrë malli për familjen time që nuk i kam pa qe dy vjet.

K. Zeka: Jusufi nuk pajtohet me ty, ai është krejtësisht në pozitat e Tezave tona. Këto teza që po i sheh në tavolinë janë të radhitura e rishkruara nga Jusufi.

S. Novosella: Jusufi pajtohet me mua dhe jo me ty.

K. Zeka: Ty ka me të dalë punë me Jusufin!

S. Novosella: Jo mua po ty ka me të dalë punë me Jusufin kurrë ta merr vesh thelbin e interpretimit të këtyre tezave që nuk ke guxua me ia bërë atje, por ke ardhë tek unë.

K. Zeka: Çka jeni kaq aq shumë pas atij njeriu?

S. Novosella: Është punë për ne për kend kapemi. A jam duke të pyetur unë ty se pse je kap aq shumë pas këtij apo atij njeriu?!

Bardhi tregon se gjatë kthimit, Kadriu ishte si një tjetër njëri. Atij dhe shokëve të tij më të ngushtë iu kishte ra sharra në gozhdë tepër keq. LNÇKVSHJ-a u kishte dalë kafshatë që nuk kapërdihet aq lehtë. Për dallim nga Kadri Zeka, Bardhi nuk e ka ndier veten për asnjë moment keq nga kjo rrugë, edhe "*pse Sabri Novosella sillet shumë keq jo vetëm ndaj Kadri Zekës por edhe shokut të Organizatës së vetë Bardhoshit."*

Thelbi i prishjes së Sabriut me Kadri Zekën në Stamboll qëndron në faktin se Kadri Zeka e ka fyer Sabriun duke i thënë se ai (Sabriu) nuk është komunist i modës sikurse që janë ai vetë (Kadri Zeka), Mehmet Hajrizi e Brat Berat Luzha. A ka fyerje më e rëndë e ulje e reputacionit se sa ta akuzosh një rrobaqepës të klasit të parë se nuk din çka është moda, se nuk është në gjendje ta përcjellë modën.

14. A vlejnë këto fjalë edhe për mua?

Në Panairin e librit në Frankfurt, të shtunën me 17 tetor, një ditë pas kthimit nga Stambolli, Jusufi ka rastin të takohet vetë me Kadri Zekën. Është shumë interesant thelbi i bisedës së tyre në Frankfurt, për të parë se "kujt i del punë me Jusufin e kujt jo?" Kadriu e din se Jusufi është informuar shumë saktësisht nga Bardhi se si kanë shkuar bisedimet në Stamboll dhe për atë çështje ai nuk lodhet me i përsëritë gjërat, dhe se pikërisht misioni i Bardhit në këtë rrugë ka qenë mision i dëshmitarit, që ky Besnik në aq mënyrë besnike i përshkruan. As Jusufi nuk humbë kohë me Kadriun për ta pyetur shumë se a janë të vërteta fjalët e Bardhit. Jusufi, sa është i qartësuar dhe i kënaqur për qartësimin e shumë gjërave është edhe aq i revoltuar për shkakun se si është e mundur që Kadri Zeka, Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi dhe Berat Luzha t'ia japin vetes të drejtën për të vendosur, për ta etiketuar e klasifikuar Jusufin si individ, dhe si anëtarë i një Organizate, pra të vendosin ata dhe askush tjetër, as më shumë e as më pak se: a është Jusufi komunist apo nuk është?! Dhe jo vetëm kaq, por është shumë i revoltuar se si këta komunistë të paepur gjer në fund i kanë kërkuar ndihmë Jusufit (edhe pse jokomunist) për t'ua përgatitur 3 numra të *Lirisë* dhe për t'ua dërguar në Kosovë në ditët më kritike, dhe në të njëjtën kohë luftojnë me çdo kusht ta mbajnë në distancë të sigurt duke e etiketuar si jokomunist.

Thelbi i bisedës së Jusufit me Kadriun më 17 tetor 1981 në Frankfurt, të cilën Jusufi ma transmeton menjëherë pas mbarimit të saj është:

Jusufi: Bardhi më tregoi se ti dhe shokët e tu e konsideroni LNÇKVSHJ-në si organizatë jokomuniste?

Kadriu: Është e vërtetë se LNÇKVSHJ nuk është Organizatë komuniste.

Jusufi: Se në LNÇKVSHJ ka mjaftë individë që nuk janë komunist, qoftë për shkak të bindjeve të formuara me kohë, qoftë për shkak se ende nuk kanë arritur të krijojnë botëkuptimet e tyre, këtë e pranoj.

Kadriu: Nuk është fjala për individ, cili është e cili nuk është komunist, cili mund të jetë e cili mund të mos jetë komunist. Në LNÇKVSHJ asnjë anëtarë i vetëm nuk është komunist.

Jusufi: Këto fjalë i thua ti duke më përfshi edhe mua. A vlejnë këto fjalë edhe për mua?

Kadriu: Edhe për ty.

Jusufi: Ta zëmë se nuk qenkam komunist në ditën e sotme. A mendon ti dhe shokët e tu se unë si individ kam gjasa që të bëhem komunist dhe të meritoj të quhem komunist ndonjëherë në të ardhmen?

Kadriu: Pa u lodhur se si do të jetë e ardhmja dua të them atë që është kryesorja tani, se ti nuk je komunist!

Jusufi: A mendon ti sipas kritereve tuaja, se të gjithë anëtarët e OMLK-së me të vërtetë janë komunist të formuar.

Kadriu: Çdo anëtarë i OMLK-së është komunistë i formuar.

Jusufi: Tani i kuptoj plotësisht Tezat e juaja dhe seriozitetin që meritojnë ato. Edhe pse njihemi personalisht që nga marsi, njohja në këto 3-4 ditët e fundit është shumë cilësore.

Kadriu: Duke e parë relacionin tonë të deritanishëm në dritën e fakteve të reja konkrete që dolën nga rruga në Stamboll, a je i hidhëruar në mua dhe komunistët tanë që të jemi sjellë ndaj teje në atë mënyrë që ta do ta jepte të drejtën edhe ta quash shfrytëzim?

Jusufi: Unë kam qenë tepër i vetëdijshëm se çka kam bërë dhe për këtë nuk pendohem por jam krenar me punën time, andaj në këtë pikë nuk ka pse

me iu vra ndërgjegjja. Në politikë e në luftë, kush i shërben kujt, kush është pjesë e një plani më të përgjithshëm, kush është pjesëza e kush është e tëra, kush e shfrytëzon kend, kush del më i paepur deri në fund, se a do jem unë një figurë episodike në Frontin tuaj të madh, apo do të jeni ju figura episodike e të modës në Lëvizjen time, në planin e idealin tim të përjetshëm nuk dihet kurrë deri në finale, deri në fund.

Kadriu: Duke e parë relacionin tonë në dritën e fakteve të reja a ke aq durim sa të pranosh të kesh kontakte me mua edhe në vazhdim dhe a ma çelë derën nëse ta mësyj?

Jusufi: "*Rrudhat mbi ballin tim, për mikun e vendlindjes, për aq sa kam pasur indikacione 34 vjet të jetës sime, kanë shprehur qartë pamundësinë për të fshehur ndjenjën e fuqishme të brengës për fatin e atdheut të robëruar; ato kanë treguar se janë* ***dyer kurdoherë të hapura*** *kah shpirti, për të gjithë ata që kanë halle të ngjashme*."

Kadriu: Ne jemi bashkuar me Frontin e Kuq, pra me Ibrahim Kelmendin. Nuk kishte pas aq anëtarë, bile me të thënë të drejtën nuk ka pse të mbetet merak pse ti nuk je bashkuar me ta para nesh!

Jusufi: Ia pafsh hajrin! Ditën e mirë!

Kadriu: Ditën e mirë!

Jusuf Gërvalla*: "Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj* ***(e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z****. [Kadri Zekën në panair, në Frankfurt, më 17 tetor - shën i Xh. D.]), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesha plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë,* ***as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 274)

Të shtunën më mbrëmje unë kthehem në Shtutgart, ndërsa Jusufi qëndron në Frankfurt natën e së shtunës dhe të dielën.

Ismail Kadare*: "Biseduam gjatë atë ditë midis rrëmujës së panairit dhe pastaj më gjatë në mbrëmje në një kafe të qytetit. Poet, prozator, publicist militant, Jusuf Gërvalla kishte të gjitha cilësitë dhe dimensionet që e bëjnë të shquar një personalitet të letrave e të kulturës. Për fat të keq mundësitë e tij mbetën të pashprehura plotësisht."* (Jusuf Gërvalla, Rrotull, Tiranë 1983, faqe 3)

Në momentin e parë që më ra të takohem me Jusufin pas kthimit nga Frankfurti, u ngjitëm në katin e tretë ku ishte studioja e punës. Në tavolinën e tij të madhe dhe në fiokat e saj gjendeshin më shumë se 100 kopje të *Tezave* që i kishte radhitur, e të cilat nuk kishte arritë me i shpërnda dhe një tubë fletëpagesash për xhirollogarinë *„Hilfe für Kosova, Katharina Asal – Biel-Biene, Konto 25-45475, Biel-Biene Schweiz".* Ai i ndau 5-6 ekzemplarë të *Tezave* që t'i ruaj në arkivin e tij dhe kopjet tjera të Tezave së bashku me fletëpagesat, në praninë time i hodhi në shportën e mbeturinave. Me këtë veprim Jusufi ka dashtë të tregoj se Kështjella e Lëvizjes së tij është Kështjellë e lirë dhe e pamvarur në pikëpamje ideore, se në shtëpinë e tij askush pos tij nuk mund ta RUAJ rolin hegjemon, se Kështjella e tij është e lirë edhe në pikëpamje ekonomike pasi nuk ka kurrfarë obligimi t'i paguaj haraç ndokujt. Në të njëjtën kohë Jusufi kurrë nuk është përzier në punët e brendshme të të tjerëve e në shtëpitë e të tjerëve.

Kjo është e vërteta e trajtimit të Tezave të OMLK-së, nga ana e Jusufit, **para** takimit të Stambollit në mes Kadri Zekës e Sabri Novosellës, takim i cili u bë në pranin e dëshmitarit besnik Bardhosh Gërvalla. Kjo është e vërteta e trajtimit të këtyre Tezave, nga ana e Jusufit, **pas** takimit të Stambollit dhe jo vetëm kaq, por edhe **pas takimit** të Jusufit me Kadri Zekën, në Panairin e librit në Frankfurt më 17 tetor 1981.

15. Festa e 28 Nëntorit 1981 në Shtutgart

Lidhur me bisedimet në Turqi Jusufi i dha plotësisht të drejt qëndrimeve të Sabri Novosellës.

Jusuf Gërvalla: *"Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj* ***(e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z****. [Kadri Zekën në panair, në Frankfurt, më 17 tetor - shën i Xh. D.]), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesha plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë,* ***as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të çoroditur, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z****."* (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 274)

Me dështimin e tyre, me daljen në sipërfaqe të qëndrimeve të OMLK-së, vendoset të fillohet me përgatitjen e Zërit të Kosovës për shtyp.

Në fillim të nëntorit punën time në Bitigheim-Bisingen, në fabrikën SWF kur edhe isha u punësuar vetëm për disa muaj, e përfundova. Situata e krijuar, dhe puna për radhitjen e Zërit të Kosovës dhe çështjet e ndryshme organizative ndikuan që unë periudhën më të madhe, nga fillimi i nëntorit e deri më 10 dhjetor 1981 ta kaloj pranë Jusufit në Untergruppenbach. Gjatë kësaj kohe me Jusufin punuam në radhitjen e numrit të parë të Zërit të Kosovës në makinën radhitëse të markës IBM, artikujt për të cilin kishin qenë gati të gjithë të gatshëm në dorëshkrim (të shtypur me makina tjera të shkrimit) qysh nga mesi i gushtit 1981. Numri i parë i Zërit të Kosovës doli nga shtypi në mesin e nëntorit 1981. Ky numër u shpërnda në gjysmën e dytë të nëntorit. Jusufi gjithashtu ia dërgoi me postë disa ekzemplarë të këtij numri Kadri Zekës në Zvicër. Më 14 nëntor në Sindelfingen, aktivistët më të dalluar të Shtutgartit e prishin një koncert të organizuar nga konsullata jugosllave e Shtutgartit.

Po në dhjetëditëshin e parë të nëntorit Kadri Zeka me Jusufin merren vesh për organizimin e festës së 28 Nëntorit. Në të vërtetë ky organizim në këtë formë bëhet me iniciativën e Kadri Zekës. Aktivistët e Shtutgartit dhe të Zvicrës për këtë festë do të mblidheshin në Shtutgart, ndërsa ata të Dyseldorfit do ta bënin një organizim në Dyseldorf. Jusufi pajtohet me propozimet e Kadriut.

Duke marrë parasysh rrjedhën e bisedimeve në Stamboll në mes Sabri Novosellës dhe Kadri Zekës, dhe Jusufit e Kadri Zekës në Frankfurt vetëm dy javë më parë, është interesant të kuptojmë interesimin e iniciativën e Kadriut që të jetë me të gjithë aktivistët e përkrahësit e tij në Shtutgart. Përveç këtyre rrethanave, që kishin ndodhur në Stamboll e Frankfurt, që ishin të njohura për mua e Jusufin në atë kohë, është edhe një rrethanë shumë e rëndësishme që nuk ka qenë e njohur për ne, në ne rrethin e Jusufit e kjo ka qenë ajo që Jusufi e quan më vonë thirrja **FAMSHME "Të gjithë në Front! të gjithë për Frontin!".** Pra në kohën kur Kadri Zeka propozon që organizimi i festës së 28 Nëntorit 1981 të bëhet në Shtutgart, ai veç e ka në dorë THIRRJEN E FAMSHME "Të gjithë në front! Të gjithë për Frontin!" por e pret momentin e përshtatshëm për ta bërë këtë publike, e ky moment i përshtatshëm është pas mbarimit të festimit të 28 Nëntorit 1981.

Në dukje, me ardhjen e aktivistëve të Zvicrës në krye me Kadriun fitohet përshtypja se nderohet e respektohet Jusufi. Plani i vërtetë është që t'i thuhet Jusufit se Dyseldorfi iu ka bashkuar "Frontit Popullor për Republikën e Kosovës", ndërsa Shtutgarti nuk është bahçe e Jusufit dhe Lëvizjes së tij, por është terren që OMLK-ja e konsideron si të vetin. Me këtë rast, aktivistëve të Shtutgartit iu ipet rasti të influencohen nga entuziazmi e organizimi në Zvicër. Por e njejta gjë vlen edhe në drejtimin tjetër. Aktivistët e Zvicrës kanë rastin edhe njëherë të shohin se kush është Jusuf Gërvalla dhe cilat janë mendimet e tij konkrete për ato ditë në të cilat po kalonin forcat e organizuara.

Për këtë festë Kadri Zeka merr detyrën që të flas kundër revizionizmit jugosllav, pasi ai e ndjente veten më kompetent në këtë pikë, Jusufi merr përsipër të trajtoj çështjes e kërkesës "Kosova-Republikë" ndërsa unë e shkrova artikullin për 28 Nëntorin, me titull "Kur s'është dëgjuar fjala është ndier pushka e shqiptarit". Ky artikull i botua në numrin 2 të Zërit të Kosovës, në Janar 1982. Përveç këtij shkrimi ato ditë për numrin 2 shkrova edhe dy artikuj tjerë: "Me dyqind e ca komunista lule nisi Shqipëria historinë e kuqe" dhe "Një ditë që na i burrëroi edhe fëmijët". Jusufi ishte i kënaqur me këtë punë dhe në një rast më tha: Nuk po dua me krijua skena, por mendoje se të përqafova për këtë punë, dhe ta dish, se prej tani, sa i përket çështjes së luftës me penë, nuk e ndiej veten vetëm.

Gjatë mbrëmjes së 28 Nëntorit 1981, Jusufi i shkëmben këto fjalë me Kadriun:

Jusufi:	Si t'u duk ty dhe shokëve tjerë në Zvicër, "Zëri i Kosovës"?
Kadriu:	Mund të përgjigjem për vete por edhe për shokët e Zvicrës megjithëse ata nuk e kanë pa, pasi ne nuk e kemi ndërmend me e shpërnda Zërin tënd në radhët tona.
Jusufi:	Ani mirë, por megjithatë jam kureshtar si t'u ka dukur ty e me këtë edhe atyre, pasi ti flet në emër të tyre?
Kadriu:	Zëri yt është plagjiat.
Jusufi:	Plagjiat i kujt?
Kadriu:	Plagjiat i Lirisë.

Në kohën kur OMLK-ja dhe Kadri Zeka, e mbajnë Thirrjen e tyre të FAMSHME "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!" të fshehur, duke e pritur momentin e përshtatshëm, Jusufi i thotë hapur mendimet e tija në referatin e asaj mbrëmje, që ishte edhe kryeartikull i numrit të dytë të Zërit të Kosovës, me titull "T'I JAPIM SHTYTJE TË RE LUFTËS", i cili u lexua nga Jusufi në mbrëmjen e 28 Nëntorit, pos tjerash, thuhet:

Jusuf Gërvalla*: "Karshi zhvillimit të tillë të ngjarjeve, për forcat tona të organizuara patriotike e revolucionare, për rininë dhe popullin tonë dalin detyra serioze, të barasvlershme me përpjekjet historike shekullore për ekzistimin e kombit shqiptar në tërësi dhe për këmbënguljen në realizimin e të drejtave të ligjshme të pjesës së robëruar të popullit tonë nga shovinistët jugosllavë, në veçanti.*

Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike dhe revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvuajtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. ***Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e 'politikës së madhe', lojën e ARRIVIZMIT revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh MEGALOMANË (***fjalët i drejtohen Kadri Zekës dhe shokëve të tij - shën im)*, dhe* ***ato që janë organizuar prej ELEMENTESH TË DYSHIMTA****, (këto fjalë i drejtohen ish-policit politik Abdullah Prapashtica - shën im) e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar. Gjaku i derdhur, burgu i zi dhe terrori çnjerëzor që po ushtron mbi bijtë e bijat e Kosovës trime, na obligon që Atdheut tonë t'i dalim hakut me një dashuri që bëhet, - siç thotë ... - me ngut, me alarm, me përpjekjet mbinjerëzore të luftëtarëve të vërtetë të lirisë."* (Zëri i Kosovës, nr. 2 janar 1982, faqe 2, shtylla 2)

Jusuf Gërvalla*: "Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës,* ***por MEGALOMANINË E ARRIVISTËVE të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për dominim me çdo kusht mbi të tjerët****."*(Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

16. Kërkesa e Jusufit rreth Kongresit VIII të PPSH

Është edhe një ngjarje me rëndësi që është zhvilluar në panairin e Librit në Frankfurt. Më 1 nëntor 1981 do t'i fillonte punimet Kongresi VIII i PPSH. Jusufi ishte shumë i interesuar të siguroj xhirime filmike sa më të plota nga zhvillimet e punimeve të Kongresit, me qëllim që të fitohej njohuri organizative për punën tonë që bënim në Gjermani. Për këtë arsye ai (Jusufi) kishte blerë një televizorë të cilësisë së lartë dhe dy videoaparate (VHS) të cilat ia dorëzon Engjëll Kolanecit. Në fillim të dhjetorit 1981, nga Shqipëria vjen përgjigje lidhur me kërkesën e Jusufit për videoxhirimet e punimeve të Kongresit VIII. Engjëll Kolaneci ia sjell Jusufit pesë videokaseta VHS, me këto filmime:

- Epoka para Gjyqit, Dramë (Sylejman Pitarka e Kadri Roshi)
- Gërsheti i Luftërave, Dramë për Shote dhe Azem Galicën (Liri Lushi)
- Mësonjëtorja, Film (Roza Anagnosti etj.)
- Udha e shkronjave, Film
- Plumba Perandorit, Film

Siç shihet, përgjigjja që vjen në kërkesën e Jusufit është shumë interesante. Asnjë minutë i vetëm rreth Kongresit VIII. Porosia është e qartë si drita e diellit. Me fjalë tjera Jusufit i thuhet: Ti me Lëvizjen tënde Nacionalçlirimtare je në rrugë dhe në ide të drejta. Koncentrohu në çështjen kombëtare, dhe merr mësim nga Mësonjëtorja e Korçës, Abdyl Frashëri, Azem e Shote Galica dhe Vasil Laçi e mos u lodh për luftën ideologjike të Partisë së Punës, pasi për atë punë jemi ne vetë. Faza e metodat e luftës sonë janë të ndryshme me tuajat.

17. THEMELI ËSHTË VËNË ME TË PAVËRTETA

Hydajet Hyseni: *"Por siç i ishte ankuar Jusufi Kadriut, ishte pikërisht kjo që kishte shkaktuar disa keqkuptime me ndonjë veprimtar të shquar me të cilët Jusufi ishte në lidhje."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

Më 7 dhjetor 1981, me postë, paradite, me sa më kujtohet, ka ardhur tek Jusufi një zarf postal me dy dokumente në te. Njëri ka qenë ftesa personale, individuale apo familjare për Jusufin, për dasmë dhe tjetri ka qenë një dokument me titull "Thirrje - Të gjithë në Front të gjithë për Frontin", që në bazë kishte të pavërtetën, pra ishte një lloj testimi se mos këtë të pavërtetë e këtë manovrim po e përbinë edhe Jusufi. Jusufi po atë ditë, në praninë time i shkruan këtë përgjigje Kadri Zekës.

Jusuf Gërvalla (DRINI): "*Thirrjen për bashkim me frontin po ta kthej ashtu si ma dërgove. Ato që thuhen në të për bashkimin e të gjithë organizatave komuniste, patriotike e revolucionare, dhe që, sipas meje, përbëjnë themelin e kësaj thirrjeje, janë në kundërshtim me informatat më të reja që kam marrë nga shokët e Lëvizjes. Si janë sjellë punët këto kohët e fundit, në gjithë çështjen ka gjëra të mjegullta (dëshiroj të gabohem nëse them se mjegullimi ka ardhur nga mënyra e veprimit të shokëve të Organizatës m-l).*

Për mua konkretisht, dhe shokët e Lëvizjes me të cilët kam kontakt, thënia në "Thirrje", ku thuhet se është bërë bashkimi i organizatave, nuk është e vërtetë, së paku deri në këtë çast, ndërsa thirrja është shkruar shumë më herët.

Ju po deshët mund të delni me atë thirrje. Por duhet të jeni të vetëdijshëm se çfarë mund të jenë sukseset dhe konsekuencat e një pune, në dokumentin e parë të së cilës themeli është vënë me të pavërteta." (Letër Kadri Zekës, 7 dhjetor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 277)

18. NE DO TË DALIM PUBLIKISHT ME SHESHIMIN E TË PAVËRTETAVE

Hydajet Hyseni: *"Por siç i ishte ankuar Jusufi Kadriut, ishte pikërisht kjo që kishte shkaktuar disa keqkuptime me ndonjë veprimtar të shquar me të cilët Jusufi ishte në lidhje."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

Jusuf Gërvalla (DRINI): *"Në lidhje të ngushtë me këtë, po dolët me thirrjen pa u kristalizuar mirë të gjitha çështjet e bashkimit, ne do ta konsiderojmë se* ***keni bërë përpjekje për t'i vënë disa forca të caktuara patriotike e revolucionare para një akti të kryer, në mos e teprofsha, me manovrime nga ana juaj.***

Prandaj, mos u habitni nëse pas hapit tuaj ne do të dalim publikisht me sheshimin e të pavërtetave." (Letër Kadri Zekës, 7 dhjetor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 277)

Për këtë arsye, si rezultat i dokumentit "Thirrje - Të gjithë në Front të Gjithë për Frontin", po atë ditë në mbrëmje, më 7 dhjetor 1981 (këtë datë e përmendi në bazë të librit Terror, Dhimbje, Qëndresë, të Faridin Tafallarit, f.46), në studion e punës së Jusufit betohen edhe njëherë individualisht para Jusufit, si anëtarë të ***Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi***, Sefedin Tafallari dhe vëllau i tij Faridini, Remzi Ademaj, Nuhi Sylejmani nga rrethi i Kumanovës, Mejdi Rexha nga Korisha dhe dy të tjerë. Në këtë rast jo vetëm që shprehen qëndrimet e palëkundura të Jusufit, por me këtë hap e konsideron edhe si punë plotësuese të letrës që ia dërgon "Frontit". Në mbrëmjen e 7 dhjetorit 1981, tek Jusufi kam qenë edhe unë.

Faridin Tafallari: *"Më 7 dhjetor të vitit 1981 Jusufi ftoi disa nga shokët e këtij rrethi për të bërë betimin. Më ftoi edhe mua... U nisëm dhe unë mora me vete vëllaun tim,* ***Sefedinin****, pasi isha marrë vesh edhe me Jusufin. Vëllai kishte shfaqur dëshirë për këtë gjë."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 46)

Në këto ditë, me Jusufin punuam në përgatitjen e numrit 2 të Zërit të Kosovës, që doli në Janar 1982.

19. Tik-taket e orës në Untergruppenbach

Tik-taket dhe orët gjatë ditëve që më ra të qëndroj pranë Jusuf Gërvallës, kishin një përzierje shumë të këndshme në mes rinjohjeve dhe origjinalitetit.

Pas mëngjesit dhe pirjes së kafeve në studion e tij fillonte puna. Sa i përket shkrimit të artikujve të mi, pjesën kryesore i kisha shkruar në Ludvigsburg. E ndonjë prej shkrimeve i kisha bërë në Untergruppenbach. Sa i përket punës së radhitjes me makinën IBM, me te punonte më së shumti Jusufi ndërsa unë ia lexoja artikujt. Gjithashtu para se ta bënte shtypjen përfundimtare të një shtylle nga memoria e makinës, kohë pas kohe Jusufi bënte shtypje të pjesëve të caktuara në letër dhe kërkonte nga unë leximin e tyre dhe mos gjeja ndonjë gabim. Kur unë i thosha se në pikëpamje drejtshkrimore unë nuk kam çka i ndihmoj atij në asnjë pikë, ai prapëseprapë e kërkonte këtë duke thënë se njeriu e ka shumë më lehtë me i gjetë gabimet e të tjerëve se sa të vetat. Natyrisht se në fund kontrollin kryesor e bënte vetë, por hetimi i ndonjë gabimi prej anës time atij i kursente kohë. Disa artikuj më ra t'i radhisë edhe unë duke ma lexuar tekstin ai, dhe në këtë mënyrë unë i mësova operacionet elementare të shkrimit me atë makinë shumë të avancuar për atë kohë.

Afër makinës, gjatë tërë kohës së punës, që në fillim qëndronte një qiri i trashë i ndezur, që jepte flakën e tij. Ndezja e qiririt ishte një ritual i punës së përditshme të Jusufit në tavolinën e tij të punës. Çdo ditë pas dite, rreth orës 15.00 ai e kishte të caktuar për një

sy gjumë efektiv që për te zgjaste prej 15-30 minuta. Pas këtij gjumi, ai në koncentrimin e tij dukej po aq i freskët sikur pas gjumit të natës, freski që e shoqëronte gjer në orët para mesnate. Për t'iu përshtat ritmit të tij, këtë stil të kalimit të ditës ato ditë e kopjova edhe unë. Në ditët e para, kur ai shkonte të bënte minutat e tij të gjumit të pasditës, hyra edhe unë në dhomën e mysafirëve dhe e përgatita vendin, me kokë nga dritarja e dera e madhe e xhamit, që ishte në anën e kopshtit përballë të cilave ishin duke u ndërtuar disa shtëpi ende të pambaruara. Kur Jusufi e pa se si e përgatita vendin, më tha: -Mos bir në atë drejtim, me kokë nga dritarja se mos po e han në vend të tjetërkujt. Pra ai kishte një parandjenjë të fortë se ndërtesat e papërfunduara përballë garazhës së tyre mund të përdoreshin nga vrasës, snajperist. Por edhe kur ma tërhoqi vërejtjen më duket se u shqetësua pak pse më tha ashtu duke menduar se mos unë po frikësohesha nga ajo që më tha.

Ditëve të javës, ditëve të punës ndodhte që ndonjë prej punëtorëve të vinte tek ai. Mungesa e telefonit bënte që vizitat e tilla gjatë ditës nuk mund të paralajmëroheshin. Por Jusufin gjithmonë e gjenin të gatshëm. Këto vizita nuk e konsideronte gjëra që e pengonin punën e tij, por pikërisht ishin oksigjeni i punës së tij. Asnjë prej shokëve të Jusufit, kurrë nuk kishte arsye me kërkuar ndonjë motiv se pse u kthye kah Untergruppenbachu. Por shpesh ka mund të ndodhë e kundërta. Nëse ndonjë shok, është dukur pas periudhe më të gjatë kohore, ai ndoshta e ka filluar bisedën me disa fjalë për ta "arsyetuar mungesën e tij".

Sa i përket të shtune-dieleve, Jusufi e Bardhoshi i pritnin ato me gëzim, megjithëse motivet e tyre nuk ishin krejtësisht të njejta. Jusufi i priste vikendet që ato t'i shfrytëzoj sa më shumë që të ketë mundësi të takojë punëtorët të cilët këto ditë ishin në pushime. Edhe Bardhoshi kishte dëshirë t'i vizitojë punëtorët së bashku me Jusufin, por të shtunet i priste ai edhe për të pasur mundësi të pushonte pak, që këtyre ditëve të pushimit të çohej pak më vonë, pra pa rënien e ziles së orës si në ditët e punës.

Megjithatë Bardhoshi përkundër lodhjes së tij, gjithmonë e kishte parasysh nevojën e Jusufit. Në këtë punë, për ta marrë Jusufin dhe për të dalë me te, e zëvendësonte Bardhin nganjëherë Remzi Ademaj. Se Bardhoshi ka pasur nevojë vitale për pushimin e të shtune-dieleve (qoftë edhe vetëm të paraditës), në thelb, në tërësi e kam kuptuar shumë vite më vonë, ndërsa gjatë muajit dhjetor 1981, një rast me te më ka mbetur i paharruar. Shkuam njëherë së bashku në një qendër tregtare, kompleks në të cilin gjendej edhe një vetëshërbim të madh për të blerë artikuj ushqimor. Në kohën kur shkuam, parkingu ishte plot me kerre. Ne u sollëm disa minuta për të kërkuar vend dhe nuk gjetëm. Atëherë Bardhoshi shkoi dhe e parkoi në vendin që është i rezervuar për invalid pasi aty qenë dy-tri vende të vetme që ishin të lira. Unë i thash:

– Çka bëre kështu Bardh! - e dinë që kanë me ta qitë dënimin?

Bardhoshi qeshi pak dhe më tha: Jo nuk ma qesin, se e kam lejen të cilën e vendosa në te dritarja dhe ruajtësit e parkingut e shohin.

Unë nuk fola asnjë fjalë më tutje në këtë drejtim, e edhe ai u mjaftua me aq.

Gjatë atyre muajve, sa i përket udhëtimeve më së shumti më ka rënë të udhëtoj me Bardhoshin, sidomos në rrugën Ludgwigsburg – Untergruppenbach. Përveç me Bardhoshin, këtë rrugë shumë e herë e kam bërë edhe me tren - deri në Heilbronn, dhe nga aty me autobus për në Untergruppenbach. Me Bardhin dhe Jusufin më ka rënë të udhëtoj e t'i vizitojmë disa nga shokët më të afërm të rrethit të Shtutgartit. Jashtë rrethit të Shtugartit i kam bërë vetëm dy udhëtime. Më 17 tetor 1981, kur nga Untergruppenbacu jemi nisur me Jusufin dhe Bardhoshin për në panairin e librit në Frankfurt. Udhëtimi tjetër është rreth 10 dhjetorit 1981, kur Jusufi më ka përcjellë së bashku me Naim Haradinajn deri në Munhen, kur unë udhëtova për në Kosovë, për punë e për llogari të Lëvizjes së Jusufit.

20. DIGA E DRINIT

Në dy letrat e Jusufit dërguar Kadri Zekës, atë të 7 dhjetori 1981, dhe tjetrën më 15 janar 1982, Jusufi i nënshkruan me njërin prej pseudonimeve të tij, DRINI. Vendosmëria e tij në ndihmën për gazetën Bashkimi gjatë vitit 1980, në shenj respekti për punën e të tjerëve të filluar para tij, është e dëshmuar. Edhe më e dëshmuar është vendosmëria e tij për t'i ndërprerë të gjitha marrëdhëniet me këtë gazetë dhe përfaqësuesin e saj, në fund të dhjetorit 1980, në kohën kur Jusufi ka baza të forta për të dyshuar se pas Frontit të Kuq qëndron UDB-a dhe filiala e saj, Tanjugu. Pra Jusufi kurrë në jetën e tij nuk ka thënë as me gojë e as me shkrim se ndonjë organizatë që e ka krijuar apo emërtuar UDB-a, siç e kemi rastin tek Fronti i Kuq, ka bilanc të përgjithshëm pozitiv. Sikur Jusufi të kishte menduar kështu ai kurrë nuk i kishte ndërprerë të gjitha marrëdhëniet me gazetën Bashkimi të Frontit të Kuq në fund të dhjetorit 1980. Jusufi e kupton se atyre që u ka ndihmuar nuk e kanë merituar ndihmën e tij. Por kjo nuk do të thotë aspak se ai është penduar për fjalët dhe artikujt e tij, të botuar në gazetën Bashkimi, të cilët janë përjetësisht pronë e tij, dhe jo e bashkëthemeluesve dhe emërtuesve të Frontit të Kuq. Edhe Rilindja ka qenë organ i Frontit të LKJ. Fati i LKJ dihet, dhe fati i shkrimeve të Jusufit në faqet e Rilindjes është krejtësisht tjetër me atë LKJ. Pronar i shkrimeve të Jusufit në Rilindje është Jusufi dhe jo LKJ-a. Vendosmëria e Jusufit-Drinit i përngjan apo është shumë më e madhe se e Digës apo digave të Drinit. Në vitin 1981 në disa aspekte mund të thuhet se kemi pjesërisht një reprizim të ngjarjeve të vitit 1980. Në pjesë të mirë të këtij viti (1981) Jusufi i përdorë energjitë e tij për ta ndihmuar revistën Liria dhe Organizatën Marksiste-Leniniste të Kosovës, OMLK. Në mesin e tetorit 1981 ai e kupton se kjo organizatë, udhëheqësit e saj, pikënisje për raporte me të tjerët kanë ruajtjen e rolit hegjemon, se me Lirinë e tyre do të na e sillnin lirinë e ruajtjes së rolit hegjemon. Në tetor të vitit 1981 Jusufi e kupton se ndihma e tij është keqpërdorë, atë ndihmë pranuesit e saj nuk e kanë merituar. Edhe në këtë rast Jusufi është shumë i vendosur dhe e ndërprenë ndihmën e tij për revistën Liria, por kurrë nuk pendohet për ndihmën që ia ka dhënë.

Por roli dhe qëndrimi kryesor, si Digë e pakalueshme, Jusufi-Drini është në raport me shokët e tij në Shtutgart, sidomos me ne të rinjtë të cilët ndodheshim në Gjermani, dhe të cilët nuk i kishim të rregulluara lejen e qëndrimit apo të punës. Edhe pse me aktivitete të dëshmuara, Jusufi nuk kishte lejuar asnjë person në rrethin e tij të kërkoj azil në Shtutgart gjatë vitit 1980. Këtë qëndrim e mbajti edhe gjatë vitit 1981 e gjer në vdekje. Këtë qëndrim e mbajti edhe ndaj meje. Kur u ndodha në korrik 1981 në Shtutgart, unë mendoja se ndoshta pa kaluar ndonjë kohë e gjatë do të kërkoj azil, por planet e tilla u fundosën menjëherë pas takimit me Jusufin. Kur e diskutova këtë çështje me te, ai kategorikisht e hodhi poshtë si të panevojshme. Asnjë prej shokëve të rinj këtu nuk ka kërkuar azil, më tha. Pasi e ke pasaportën, Bardhi mundet me të ndihmuar me punë, Haxhiu apo Naimi poashtu. Kur keni punë i ndihmoni vetes dhe njëri-tjetrit. Qe ku jemi ne, jam unë. Në Ludvigsburg e keni Bardhin, e keni Sinan Gagicën si pikë mbështetëse. Në këtë drejtim qëndrimet e Naim Haradinajt dhe Haxhi Berishës ishin edhe më të ashpra. Jusufi ishte shumë i kënaqur që unë kisha pasaportë jugosllave, dhe isha person që nuk më njihte askush pos atij, Bardhoshit, Haxhi Berishës e Naim Haradinajt.

Me insistimin tim dhe me ndihmën e Jusufit unë nisem për Kosovë, rreth 10 dhjetorit 1981, me qëllim që ta pranoj "Zërin e Kosovës" në Slloveni dhe të organizoj shpërndarjen e tij në Kosovë. Unë nuk dija datë të saktë e nuk kisha idenë se kush prej rrethit të Shtutgartit do të merrej me sjelljen e Zërit në Slloveni dhe as ata nuk do të dinin për mua. Me Jusufin isha marrë vesh që të dalë në Slloveni në rrethinë të Bledit, dhe prej

aty të bëja telefon tek fqinjët e tyre, familja Lindmeier. Poashtu qëllimi im ishte të kontaktoj me një jurist, (S. K.) i cili do të na ndihmonte në trajtimin juridik të dënimeve që bëheshin nga pushteti jugosllav, të mbledhi informata për ngjarjet prej qershori deri në dhjetor në Kosovë. Për këtë qëllim Jusufi dhe djali i Ismail Haradinajt - Naimi, nga Gllogjani, më kanë përcjell deri në Munchen. Në Munchen kemi bujtë ne të tre një natë tek Misin Mavraj. Kjo rrugë është rruga e vetme (e para dhe e fundit) që e kam bërë për në Kosovë pas njohjes me Jusufin e për të gjallë të Jusufit. Këtë rrugë e kam bërë për t'i shërbyer Jusufit. Të gjitha shpenzimet rreth kësaj rruge m'i ka paguar Jusufi.

Në këtë drejtim, pritja ime që m'u bë nga Jusufi, e cila ishte e paharrueshme dhe më me ndikim në rrjedhat e jetës sime, kishte thelbin apo epilogun e saj ashtu edhe siç mund të pritej nga Diga e Drinit: -Kthehu nga ke ardhur!

Jusufi më përcolli me Naimin për në Kosovë në Stacionin e trenit të Mynhenit. Në ditët në vazhdim kisha disa kontakte direkte e indirekte përmes telefonit.

Pas ndonjë dite qëndrimi në Kosovë, kam udhëtuar për në Slloveni, sipas marrëveshjes me Jusufin. Nga Bledi, ku kisha dalë së bashku me Bahtir Haradinajn, e kam thirrur Suzanën në telefon (tek familja Lindmeier) dhe ajo më ka thënë të largohem menjëherë nga Sllovenia pasi ata që kanë pas me e sjellë gazetën janë zënë nga policia jugosllave (bëhet fjalë për arrestimin e veprimtarëve **Shaban Klaiqi e Islam Rafuna**: Lexoni "Si u dënuan Shaban Klaiqi e Islam Rafuna për Zërin e Kosovës" në www.pashtriku.org). Pasi jemi kthyer nga Sllovenia në Kosovë së bashku me Bahtir Haradinajn, pas një nate apo dy, Televizioni Shqiptar e komunikoi lajmin e „vetëvrasjes" së Mehmet Shehut. Lajmi i „vetëvrasjes" së tij ka qenë lajm shumë i rëndë për ne që i kishim sytë e zemrën të kthyer nga Shqipëria.

Gjatë ditëve në vijim jam angazhuar me të gjitha aftësitë e mia të merrem me detyrat tjera që kisha marrë nga Jusufi.

Pas mesit të janarit 1982, më 19 janar, një mëngjes, kemi dalë së bashku apo e kemi lënë të takohemi në Prishtinë (kjo nuk më kujtohet me saktësi), me Asllan Muharremin, i biri i Behram Muharremit nga fshati Mihaliq, komuna e Vushtrrisë, i cili tani jeton me familjen e tij në periferi të qytetit Malmö, në jug të Suedisë. Kemi shkuar në Qendrën e Rinisë dhe kemi zënë vend në një kafe. Derisa unë isha ulur për të porositur kafet, Asllani shkoi në një kioskë të afërm për me e ble „Rilindjen". Pas disa minutave erdhi Asllani dhe më thotë se ka lexuar një lajm shumë të keq në „Rilindje", të 19 janarit 1982, duke ma dhënë gazetën të hapur në faqen ku ishte lajmi, në të cilin lexova me sa vijon:

Në RF të Gjermanisë

U VRANË TRE EMIGRANTË

Sipas kumtesës së policisë këta janë Bardhosh e Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka

Bon, 18 janar - (TANJUG)

Policia e Shtutgardit kumtoi se gjatë natës së kaluar në vendin Untergrupenbah, afër Hajlbronit, në Krahinën Baden-Virtenberg u vranë tre emigrantë me prejardhje jugosllave. Këta janë Bardhosh Gërvalla (31), Jusuf Gërvalla (36) dhe Kadri Zeka (28).

Policia ende po i gjurmon dorasit, por mund të supozohet se është fjala për qërim tipik hesapesh midis emigrantëve të nëntokës së RFGJ, të cilëve, siç mendon policia i kanë takuar edhe viktimat e kësaj përleshjeje. Ky supozim jipet nga rezultati i parë i hetimeve të policisë, i cili nuk është definuar në mënyrë plotësisht të qartë, por që është mjaft indikativ. Konsiderohet në të vërtetë se "fjala është për krim me prapavijë politike",

sepse ndërmjet emigrantëve të këtij lloji të orientuar armiqësisht ndaj Jugosllavisë, ka më shumë "rryma" dhe "grupacione".

Bardhosh e Jusuf Gërvalla, siç merret vesh, janë vëllezër. Ata tash, sipas të gjitha gjasave, janë bërë viktima të mesit, të cilit i kanë takuar. Viktima e tretë, Kadri Zeka, siç pohon policia, para kësaj, ka jetuar në Zvicër, ku ka pasë marrë azil. Nuk ka dyshim se të vrarët tash një kohë të gjatë kanë jetuar në RFGJ.

Policia e Shtutgardit kumtoi se ka organizuar ndjekje përmasash të gjera për zënien e vrasësve të mundshëm.

Qeveria e Bonit, siç deklaroi përfaqësuesi i saj për shtyp, e dënon rrept vrasjen e tre personave. Ky përfaqësues shtoi në konferencën për shtyp se "qeveria shpreh keqardhje për shkak të përleshjeve të tilla.

Ibrahim Kelmendi (fjalë të I.K. të vendosura në personin tim): *"Papritmas erdhi një polic që e njihja dhe më dha lajmin për atentatet."* (Atentatet, f.342)

Ky lajm i botuar në Rilindje, nga UDB-a, apo thënë më konkretisht nga sponsori medial i veprave të UDB-së, TANJUG-u, ishte mënyra se si u njoftova për vrasjen e Jusufit. Jo vetëm mua, por në këtë mënyrë UDB-a u përpoq ta informoj gjithë opinionin shqiptar e botëror, sikur të mos ishte këmbëngulja e pathyeshmëria e pafund e Jusufit dhe mospranimi i Tij për të hyrë në sallën e operacionit para se ta jep një deklaratë para policisë, në spitalin e Heilbronit.

Pasi leximit të këtij lajmi si kam mbërri me u përgatitë mirë në rrethanën e parë jam nisë nga Fushë-Kosova për në Shtutgart dhe në Untergruppenbach kam mbërri më 21 janar 1982, në orën e fundit (rreth orës 14.00) kur firma e varrimeve i kishte sjellë kufomat në shtëpi të Jusufit, në mënyrë që familja dhe shokët të bënin përshëndetjet e fundit. Para arkivoleve me trupat e të vrarëve kam qenë i vetmi që e kam mbajtur një fjalim.

Të shtunën më 23 janar 1982 është bërë një demonstratë në Shtutgart për të cilin e kam shkrua fjalimin "Emrat tuaj, flamuj një beteja" (Zëri i Kosovës, mars 1982, faqe 8.).

Në javët, muajt dhe pikërisht në tri vitet në vazhdim, pra nga Janari 1982 deri në Janar 1985 kam bërë udhëtime tjera në shërbim të vazhdimit e përjetësimit të veprës së Jusufit, shtytjes së luftës përpara. Udhëtimet në vazhdim, shumicën absolute të tyre, i kam bërë së bashku me shokët e Shtutgartit, e nganjëherë edhe vetëm, por edhe në këto raste gjithmonë kam udhëtuar vetëm atëherë kur kam pasur përkrahjen, ndihmën dhe kërkesën e këtyre shokëve.

Goditja e armikut në Untregruppenbach ishte një humbje e rëndë, e cila i mobilizoi bashkatdhetarët në Evropë si kurrë më parë. Organizativisht për rrethin e Shtutgartit një goditje e tillë mundet me u marrë me mend. Ne shokët e rrethit të Jusufit, të ndeshur me Digën e Drinit e me kujtimin e saj, nuk patëm të ndalur në Shtutgart, por edhe nuk mund të ktheheshim shpejt atje prej nga kishim ardhur. Të vetëdijshëm për këtë, në shenjë respekti për kujtimin e kësaj Dige, ne në formën e përroskave morëm drejtime tjera, në qytete tjera të Gjermanisë, Zvicër, Suedi e Amerikë.

Jusuf Gërvalla gjatë jetës së tij në Gjermani, e shndërroi rrethin e Shtutgartit si qendrën kryesore në Evropë, të luftës për çështjen shqiptare, pa e pasur asnjë azilant apo refugjatë politik me përjashtim të vetes. Ky plan i tij funksionoi për të gjallë të tij. Ky plan i tij sa i përket neve që ishin afër, në një farë forme - këmbëngulja për të ndaluar krijimin e një kolonie refugjatësh politik në Shtutgart, qoftë duke u thirrur në lidhjet me te apo pa këtë, për arsye më të mëdha apo më të vogla - funksionoi gjithashtu.

Ndërtesa ku ka banuar Faridin Tafallari në vitet 1980-të, në Haiterbacherstr.75, 7270 Nagold, në të cilën pas 17 janarit 1982, u bartën materialet kryesore që ishin në shtëpinë e Vëllezërve Gërvalla.

Kujtimi i Jusufit dhe argumentet e tij na larguan nga Shtutgarti, edhe pse, po të donim, argumente të tjera, për ne që ndodheshim atë ditë në shtëpinë e tij do të peshonin shumë, për t'u ndalur aty. Por plani i Jusufit, si Digë e Drinit funksionoi vetëm për rrethin e tij të ngushtë, ndërsa në 20 vitet në vazhdim, sulmi i shtetit serbomadh në Kosovë e vise shqiptare, shpërbërja e Jugosllavisë, ndikuan në rrjedha tjera, dhe ai në tërë këtë kohë nuk mundi t'ia ndaloj askujt që t'i kthej sytë përsëri nga Shtutgarti, të shkoj tek varrezat e tyre dhe nga periudha më e lavdishme e jetës së tij, të merr frymëzime për qëndresë dhe konsolidime të reja.

==========

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit
01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013

13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror*." (14 janar 1981)

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Shtator 2012-Shkurt 2026